

RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

**MBI SITUATËN E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE NË
SHQIPËRI PËR PERIUDHËN JANAR 2020-SHTATOR 2021**

DREJTUAR

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHJETOR 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Përmbledhje Ekzekutive</i>	4
<i>Hyrje</i>	12
<i>Seksioni 1 – Legjislacioni në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore</i>	13
<i>Seksioni 2: Mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna</i>	17
<i>Seksioni 3: Planifikimi dhe koordinimi i shërbimeve për të mbijetuarat në nivel qendror</i>	30
<i>Seksioni 4: Menaxhimi i rasteve nga Mekanizmat e Referimit dhe ofrimi i shërbimeve në nivel lokal</i>	43
<i>Rekomandime</i>	52

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BGJ	Barazia Gjinore
BPGJ	Buxheti i Përgjigjshëm Gjinor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHBGJ	Dhunë me Bazë Gjinore
DHF	Dhunë në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar i trajtimit të rasteve të dhunës në familje
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprimet kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje
KVDHF	Koordinatorë/Koordinator Vendor kundër Dhunës në Familje
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
MASR	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJF	Ndihma Juridike Falas
NJMF	Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QKTVDHF	Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UMPM	Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Ky raport është hartuar nga Avokati i Popullit në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Vlerësimin e Aktivitetit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe fokusohet mbi dhunën në familje dhe format e tjera të dhunës ndaj grave.¹ Raporti adreson problematikat për periudhën Janar-Dhjetor 2020 dhe Janar-Shtator 2021, duke marrë si pikënisje raportin alternativ të Avokatit të Popullit për Komitetin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) për periudhën 2016-2020. Raporti analizon informacionin që i është dërguar nga institucioneve kryesore përgjegjëse për të adresuar dhunën me bazë gjinore në nivel qendror dhe lokal, si dhe raporte të organizatave të shoqërisë civile dhe rekomandime të organizatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në këtë fushë.

Raporti përfshin zhvillimet mjaft pozitive në fushën legislative, por konstaton nevojën për hartimin e një legjislacioni më gjithëpërfshirës për të adresuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, nevojën për buxhetim të shërbimeve të specializuara, si dhe përmirësimin e legjislacionit penal në drejtim të veprës së marrëdhënies seksuale me dhunë dhe forma të tjera dhune, të parashikuara në Konventën e Stambollit, ku Shqipëria është palë.

Mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna është një nga çështjet e tjera që trajtohen, duke përfshirë rritjen e raportimeve, zbatimin e përmirësuar të masave mbrojtëse për viktimat e dhunës, përpjekjet për zbatimin dhe monitorimin e tyre, ofrimin e ndihmës ligjore për gratë e dhunuara, si dhe ndëshkimin e dhunuesve. Çështje të rëndësishme që kërkojnë më tepër vëmendje në këtë fushë mbeten diferencat e mëdha ndërmjet numrit të raportimeve dhe kallëzimeve në polici, me rastet për të cilat lëshohen urdhërat e mbrojtjes nga gjykata, nevojën për një analizë më të detajuar të shkaqeve, vështirësitë që hasen për monitorimin e masave mbrojtëse, në veçanti nëpërmjet koordinimit të aktorëve kryesorë përgjegjës. Rastet më ekstreme të dhunës - vrasjet e grave për shkak të gjinisë, të njohura si femicid - kërkojnë një vëmendje maksimale, si dhe kryerjen me përpikmëri të procedurave të vlerësimit të riskut, që ndihmojnë për parandalimin. Po ashtu, mungesa tërësore e programeve të rehabilitimit për dhunuesit është shqetësuese.

Një vend të veçantë zënë masat e ndërmarra vitet e fundit për planifikimin dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve për të mbijetuarat në nivel qendror, përpjekjet për buxhetimin gjinor dhe ofrimin e disa shërbimeve të specializuara. Por edhe në këtë fushë, ka mangësi si: nevoja imediate për rritjen e buxhetit në nivel qendror dhe lokal për këto shërbime, shtrirjen e tyre në zona të tjera për të qënë më afër grave dhe vajzave në zonat e largëta dhe rurale, angazhimin e sektorit të shëndetësisë për të raportuar dhunën, ngritjen e shërbimeve rehabilituese për dhunuesit, e të tjera. Gjithashtu, nga vizitat monitoruese të Avokatit të Popullit në dy qendrat kombëtare të trajtimit të dhunës në famije (QKTVDHF) dhe trajtimit të viktimave të dhunës seksuale (LILIUM) u konstatuan mungesa të theksuara të shërbimeve sipas nevojave të përfituesve dhe mospërmbushje të standarteve të miratuara për secilën.

¹ Raporti është përgatitur me mbështetjen e UN Women, Shqipëri në kuadër të programit të përbashkët të OKB-së në Shqipëri "Për luftën e dhunës ndaj Grave", mbështetur nga Qeveria Suedeze. Por qëndrimet e shprehura nuk janë opinionet e UN Women, OKB-së apo Qeverisë Suedeze, por vetëm të Avokatit të Popullit.

Analiza e shërbimeve në nivel lokal nga bashkitë dhe Mekanizmat Kombëtarë të Referimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore nxjerr në pah zhvillimet pozitive, si krijimi i MKR-ve pothuajse në të gjithë vendin, rritjen e rasteve të menaxhuara prej tyre dhe rritjen e shërbimeve emergjente dhe riintegruese për gratë viktime të dhunës. Po ashtu, raporti konstaton edhe problematikat si: mbledhjen më të rregullt të të dhënave, nevojën për buxhetim thelbësisht më të madh të shërbimeve të specializuara, bashkëfinancim të shërbimeve të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile, koordinim më të mirë mes anëtarëve të MKR-ve, si edhe rol më proaktiv të Njësive të Vetqeverisjes Vendore për të identifikuar raste dhune.

Rekomandimet kryesore të raportit janë:

1. Legjislacioni:

- Hartimi i një kuadri ligjor që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore – krahas dhunës në familje - si ngacmimi dhe dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyrueshme, etj.
- Ndryshime ligjore ose nënligjore për të siguruar mënyra alternative për zbatimin e detyrimeve ligjore, që për momentin janë të pamundura për shkak të mungesës së disa shërbimeve, si për shembull detyrimi që ka gjykata të urdhërojë dhunuesit të ndjekin programe rehabilitimi, të cilat në praktikë nuk ekzistojnë në pjesën më të madhe të vendit.
- Ndryshimi i përkufizimit të veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë në Kodin Penal (si për madhorët ashtu edhe të miturit), në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Ndryshime në Kodin Penal në drejtim të përkufizimit të masave ndëshkuese në lidhje me martesat e detyrueshme, si dhe përfshirjen si vepra penale të sterilizimit të detyrueshëm dhe gjymtimit gjeneral, të dy këto, krime me natyrë seksuale të parashikuara si të tilla nga Konventa e Stambollit.
- Marrjen e masave për zbatimin me efektivitet të legjislacionit të përmirësuar.
- Ndryshimi i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të mundësuar aksesin paralel të viktimave të dhunës dhe përfitueseve të ndihmës ekonomike.
- Ndryshim të legjislacionit për të evidentuar zbatimin efektiv të programeve rehabilituese për dhunuesit.
- Ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit ekzistues për tu dhënë mundësinë viktimave të dhunës në familje për tu paraqitur drejtpërdrejtë pranë institucionit të Mjekësisë Ligjore për tu egzaminuar pa qenë nevoja e pajisjes më parë të tyre me vendim nga organi procedues ose Avokati i Popullit.

2. Mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna

- Kooordinim më të mirë të MKR-ve me strukturat e policisë për të referuar në mënyrë të ndërsjelltë rastet e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës.
- Zgjerimin e fushatave ndërgjegjësuese për raportimin e dhunës në të gjithë vendin, si një mënyrë efikase për ti bërë viktimat të thyejnë ciklin e dhunës dhe të marrin ndihmën e nevojshme; shoqërimin e fushatave ndërgjegjësuese me programe për rritjen e kapaciteteve të strukturave ku raportohet dhuna.

- Marrjen e masave për shtrirjen e Linjës së Këshillimit, ose krjimin e strukturave të ngjashme në të gjithë vendin, në veçanti në zonat e thella rurale, si edhe për gratë nga grupet e pafavorizuara, si gratë me aftësi të kufizuara, ato nga komuniteti Rom, gratë e moshuara, LBT.
- Ndërgjegjësimin e gjithë autoriteteve përgjegjëse që kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të përcaktuar në ligj.
- Vënien përpara përgjegjësisë të personave të cilët marrin dënim për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës dhe nuk veprojnë në zbatim të tij.
- Aktivitetet ndërgjegjësuese kundër dhunës me bazë gjinore duhet të organizohen vazhdimisht dhe të mos kufizohen vetëm gjatë fushatave specifike, si psh fushata ndërkombëtare e 16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.
- Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e procedurave të miratuara të vlerësimit të riskut, në të gjithë vendin dhe përshtetimin e programeve trajnuese për punonjësit e policisë nga vetë institucionet shqiptare, krahas mbështetjes që ofrohet nga organizatat ndërkombëtare.
- Kontrollin e zbatimit të procedurave të vlerësimit të riskut dhe lëshimit të UMMPM, nga strukturat mbikqyrëse përkatëse dhe evidentimin periodik të problemeve që shfaqen në praktikë.
- Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për të ndarë të dhënat dhe zbatueshmërinë e urdhrave për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPM).
- Zbatimi me prioritet i largimit të dhunuesit nga banesa e përbashkët si masën e parë dhe kryesore që duhet të merret nga Gjykatat kur dhunuesi dhe i dhunuari/e dhunuara, banojnë në një strehë të përbashkët dhe gjithashtu si masa e parë në urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme që lëshohen nga policia, derisa gjykata të lëshojë urdhërin e përkohshëm të mbrojtjes.
- Shtimi i burimeve njerëzore në zyrat e përmbarimit dhe trajnim të vazhdueshëm të stafit për zbatimin me rigorozitet të UMM dhe UM dhe për të siguruar mbrojtje efektive.
- Rritje e bashkëpunimit të vazhdueshëm të zyrave lokale të përmbarimit gjyqësor, organeve të policisë dhe njësive vendore/koordinatorët e dhunës në familje, për të siguruar zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.
- Monitorim më specifik nga organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë të shkaqeve për diferencën e madhe ndërmjet raportimeve në polici dhe kërkesë-padive për marrjen e masave të mbrojtjes, me numrin e vendimeve për UM/UMB aktuale që lëshohen nga gjykatat.
- Përfshirja dhe bashkëpunimi i organeve të pushtetit vendor (shërbimet sociale, koordinatorët kundër dhunës në familje etj) për monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me detyrimin ligjor që kanë, si dhe mbajtjen e përgjegjësisë për mospërbushjen e këtij detyrimi.
- Ndjekjen e mëtejshme dhe sqarimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, komisariateve lokale dhe bashkive, për mospërputhjen e informacionit të dërguar nga Drejtoria e Policisë dhe bashkive për raportet e monitorimit të UM/UMM.
- Trajtimi në mënyrë më specifike si femicid i vrasjes së grave në marrëdhëniet familjare ose vrasja e grave në përgjithësi, në të gjithë kompleksitetin e këtij fenomeni, si dhe zbatimin me rigorozitet të procedurave të vlerësimit të riskut, në momentin e parë që raportohet apo konstatohet dhunë në marrëdhëniet familjare, për të ofruar menjëherë masa mbrojtëse të përshtatshme që

shmangin vrasjet dhe format e tjera të dhunës në familje, në veçanti largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga streha e përbashkët.

- Vënien para përgjegjesisë penale dhe administrative të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar vrasje në marrëdhëniet familjare ose dëmtime të rënda.
- Rritje e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve mbikqyrëse të sistemit të drejtësisë për të trajnuar dhe monitoruar vendimet e gjykatës për masat mbrojtëse,
- Përshejtim të procedurave të zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike të ofruar nga shteti për të mbushur boshllëkun disa vjeçar që krijoi zbatimi i ligjit për ndihmën juridike falas.
- Rritjen e numrit të viktimave të dhunës në familje që përfitojnë ndihmë juridike nëpërmjet fondeve publike (Drejtoria së Ndihmës Juridike).
- Monitorimi i lëshimit të raporteve mjeko-ligjore, i cili është shumë më i vogël se numri aktual i procedimeve gjyqësore për masa mbrojtje dhe veprës penale të dhunës në familje dhe trajnime të vazhdueshme për stafin mjeko-ligjor dhe gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, me iniciativën e vetë institucioneve të drejtësisë për to në shkallë vendi.
- Angazhim i organeve qeverisëse dhe monitoruese të sistemit të drejtësisë për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së vendimeve që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse dhe procedimet penale për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore.
- Publikimin nga Ministria e Drejtësisë brenda një kohe sa më të shpejtë të të dhënave statistikore për çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për vitin 2020 dhe 2021.

3. Planifikimi dhe koordinimi i shërbimeve për të mbijetuarat në nivel qendror

- Rritjen e financimit të projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social, në veçanti për bashkitë ku kjo nevojë është e domosdoshme për shkak të numrit të lartë të rasteve.
- Monitorimi i projekteve për ngritjen e qendrave ekzistuese dhe përdorimi efikas i fondeve përkatëse.
- Qartësimi dhe plotësimi i të dhënave mbi shpenzimet e MSHMS për shërbime të ndryshme ndaj viktimave të dhunës në familje për të cilat janë lëshuar UM ose UMM.
- Shtimi i fondeve si dhe përcaktimi i procedurave ligjore të qarta, transparente dhe kompetitive për nën-kontraktimin e organizatave jo qeveritare nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, për ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në familje (dhe potencialisht ndaj viktimave të formave të tjera të dhunës).
- Përshejtimi i masave mbështetëse nga MSHMS për MKR-të për të siguruar një funksionim sa me efektiv të të gjithë mekanizmave, në veçanti atyre të krijuara rishtazi, për të mundësuar që krijimi i tyre të mos jetë thjesht një formalitet, por një mekanizëm real që trajton rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare në të gjithë zonat e vendit, përfshi ato rurale.
- Angazhimi dhe dedikimi i fondeve publike për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve për të siguruar një qëndrueshmëri të funksioneve të tyre, përtej mbështetjes që aktualisht ofrohet nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.

- MSHMS duhet të paraqesë informacion mbi masat e ndërmarra për mbështetje financiare dhe teknike për të gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e "përshtatjes së arsyeshme", që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje.
- Nevojën për trajnime dhe mbikëqyrje të sektorit të shëndetësisë, i cili mbetet një nga sektorët ku janë shfaqur më tepër problematika në drejtim të rolit të tyre për referim të rasteve të dhunës si dhe hartimit të raporteve mjekësore mbi çdo dëmtim, të nevojshme për tu përdorur në proceset gjyqësore nga viktimat.
- Intesifikimin e masave mbështetëse dhe monitoruese nga MSHMS për mbledhjen dhe koordinimin e sistemit të të dhënave dhe shtrirjen e sistemit REVALB në të 61 bashkitë e vendit, pasi ky shërbim aktualisht realizohet vetëm në pak më shumë se gjysmën e Bashkive në vend; hedhjen rregullisht të të dhënave nga të gjithë institucionet që kanë detyrimin ligjor, në veçanti të strukturave lokale si dhe publikimin e të dhënave në mënyrë periodike.
- Përshejtimin e përpjekjeve për ngritjen e qendrave/ programeve rehabilituese për dhunuesit në të gjitha qarqet e vendit, sa më shpejt dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ pasi programet aktuale janë të pamjaftueshme.
- Nevojën për një bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse, përfshi policinë, gjykatën, shërbimet e provës dhe drejtorisë së burgjeve, për identifikimin dhe përfshirjen në programet e rehabilitimit të shkaktarëve të dhunës në familje.
- Nevojën për shtrirjen e këtyre shërbimeve edhe për shkaktarët e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhunës seksuale, ngacmimit, përndjekjes, etj.

Rekomandime në lidhje me Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të dhunës në Familje dhe Qendrës së Trajtimit të Viktimave të Dhunës Seksuale

- Zbatimin e menjëhershëm të standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje, për të siguruar të gjitha shërbimet e nevojshme, përfshi nevojat bazë të grave dhe fëmijëve që strehohen si: veshëmbathje dhe ngrohje, masat e përkujdesjes për rehabilitimin e tyre nga trauma, si dhe rritjen e kapacitetit të stafit të qendrës për njohjen e këtyre standarteve.
- Ngritja e qendrave afatgjata për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në qarqet kryesore të vendit për të qenë të aksesueshme për të gjitha gratë, përfshi ato nga zonat rurale, si dhe të aksesueshme për gratë me aftësi të kufizuara.
- Zbatimin e menjëhershëm të standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës Seksuale (LILIUM), në veçanti standardin bazë për ekzamimin e rasteve në ambientet e qendrës - pasi është çënuar parimi bazë i saj për "siguri dhe dinjitet njerëzor", mbështetjen psikologjike për viktimat, plotësimin me paisje që lehtësojnë ekzaminimet, referimin drejtpërdrejtë nga Policia në qendër të rasteve të dhunës seksuale dhe koordinimin me shërbimet e tjera mjekësore që duhet të ofrohen.
- Nevojën për ngritjen e qendrave të tjera rajonale, të specializuara për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës seksuale, pasi një qendër për të gjithë vendin, është e pamjaftueshme dhe mund të jetë e vështirë për tu aksesuar nga viktimat e dhunës seksuale që jetojnë larg vendodhjes së saj.

- Mbështetje të mëtejshme nga qeveria të organizatave jo qeveritare dhe strehëzave që mund të ofrojnë shërbime më afatgjata dhe të specializuara për viktimat, pasi zakonisht, edhe në vendet e tjera këto qendra janë më të specializuara dhe kanë më tepër kapacitete për tu ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme viktimave të dhunës seksuale.

Rekomandim për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të zbatojë detyrimet e saj të përcaktuara qartë në legjislacionin kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.

4. Menaxhimi i rasteve nga Mekanizmat e Referimit dhe ofrimi i shërbimeve në nivel lokal.

- Marrja e masave nga pushteti lokal për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve dhe koordinatorëve lokalë për menaxhimin dhe koordonimin e rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës.
- Planifikimin dhe buxhetimin e nevojshëm në nivel lokal për shërbimet e viktimave të dhunës, në mënyrë të ndarë nga shërbimet sociale, për të identifikuar specifikisht fondet e nevojshme si dhe rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve. Prioritetet buxhetore duhet të shoqërohen me identifikimin e masave konkrete për realizimin e tyre, duke pasur parasysh përfituesit direkt dhe evidentimin e tyre me shifra. Ka nevojë për ndryshimin e politikave të buxhetimit, për të bërë të mundur që fondet të jenë të përcaktuara në nivel qendror dhe lokal, pasi bashkitë e vogla nuk kanë fare fonde për të tilla shërbime.
- Vazhdimin dhe rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë të specializuara dhe kanë shpesh kapacitetet e nevojshme për të ndihmuar viktimat e dhunës, duke siguruar edhe bashkëfinancim të pushtetit vendor për këto organizata, për të siguruar qëndrueshmëri, përtej donatorëve të huaj dhe mbikqyrur aktivitetin e tyre rregullisht.
- Krijimin e qendrave/strehëzave të emergjencës, kostoja e të cilave nuk është detyrimisht shumë e madhe dhe bashkëpunimi me OJQ-të që ofrojnë këtë shërbim.
- Rritjen e mbikqyrjes në lidhje me veprimtarinë e koordinatorëve dhe Ekipeve Teknike Multidisiplinare nga Komitetet Drejtuese të Mekanizmave të Referimit, institucionet drejtuese të bashkive dhe atyre qëndrore që kanë në varësi zyrat vendore të disa prej anëtarëve të ENT, për të siguruar funksionimin e rregullt, në bazë të legjislacionit.
- Marrjen e masave administrative dhe penale ndaj anëtarëve të MKR-s që nuk përmbushin detyrat e tyre ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mbajtja dhe përditësimi i rregullt I të dhënave për numrin e rasteve të trajtuara nga MKR-të, I cili është një element i rëndësishëm në lidhje me transparencën e bashkive dhe analizën e efektivitetit të MKR-ve dhe punës së koordinatorëve të dhunës.
- Nevojën e koordinimit të ndërsjellë të pushtetit vendor me organet e policisë dhe ato gjyqësore.
- Sqarimi ndërmjet organeve të policisë dhe bashkive në lidhje me raportet e monitorimit për UM që bashkitë duhet t'i dërgojnë policisë, pasi vihet re një kontradiktë midis informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë, që për asnjë rast nga koordinatorët vendor, nuk është vënë në dispozicion

raport monitorimi dhe informacionit të dërguar nga bashkitë, shumica dërmuese të të cilave informojnë se e kryejnë këtë monitorim dhe përgatisin raporte, të cilat i ndajnë me policinë.

- Nevojën për krijimin e qendrave sociale që ndihmojnë për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje në shoqëri, në veçanti të atyre që për shkak të dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike kanë qenë të izoluara, pa mundësi për tu angazhuar në jetën sociale dhe punësim. Këto qendra mund të krijohen specifikisht për këtë qëllim, ose të integruara me shërbime që ofrohen për grupe të tjera në nevojë.
- Bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për shtrirjen dhe funksionimin e tyre në të gjithë rajonet e vendit dhe bashkëfinancimin e tyre.
- Mbikqyrjen e qendrave dhe paraqitjen e të dhënave specifike për përfituesit, për të identifikuar nevojat dhe efektivitetin e tyre.
- Shtrirjen e shërbimeve afatgjata dhe afatmesme për viktimat e dhunës me bazë gjinore në të gjitha bashkitë, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mundësi punësimi, për të siguruar pavarësinë ekonomike të grave viktimave të dhunës.
- Marrjen e masave për zbatimin sa më shpejtë të detyrimeve që rrjedhin nga VKM 327/2021 të 2 Qershorit 2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” dhe në veçanti të risive të tij, duke përfshirë:
 - Detyrimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NVV) të trajtojnë jo vetëm rastet e dhunës në familje, por edhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore.
 - Detyrimin që në bashkitë e mëdha me mbi 200 000 (dyqind mijë) banorë të krijohet një njësi kundër dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) koordinatorë vendorë me kohë të plotë që bashkëpunojnë me nga një administrator shoqëror/punonjës social për çdo njësi administrative;
 - Krijimin e Komitetit Drejtues të MKR-s dhe mbledhja e tij së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme.
 - Rritja e rolit mbikqyrës mbi ENT të Komitetit Drejtues dhe shtrirja e veprimtarisë në lidhje me efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës së shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor, në varësi të funksioneve e të përgjegjësive që ka secili anëtar i komitetit drejtues;
 - Organizimi i mbledhjeve të zakonshme të ENT-së çdo muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave.
 - Detyrimi i Policisë dhe autoriteteve të tjera për të njoftuar rregullisht koordinatorin vendor për çdo rast të raportuar dhune.
 - Realizimi për çdo rast të dhunës në familje të vlerësimit dhe menaxhimi i riskut nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse.

- Bashkëpunimi i rregullt ndërmjet Policisë dhe KVDHF për koordinimin e masave mbrojtëse afatshkurtra dhe afatgjata dhe përfshirja e koordinatorit për monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës.

Ky raport është hartuar nga Avokati i Popullit në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Vlerësimin e Aktivitetit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 ku, ndër të tjera, Kuvendi i kërkon institucionit tonë të angazhohet për përcjelljen e një raporti të detajuar për dhunën në familje.²

Fokusi: Pavarësisht se Kuvendi kërkon informacion mbi dhunën në familje, raporti trajton edhe çështje që kanë të bëjnë edhe me format e tjera të dhunës ndaj grave, duke qenë se janë të ndërlidhura. Po ashtu, gratë e vajzat janë në shumicën e rasteve viktimat kryesore të dhunës në familje dhe në bazë të legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar, Shqipëria ka detyrimin të marrë masa dhe të luftojë të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje.

Shtrirja kohore: Raporti adreson problematikat në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave kryesisht për periudhën **Janar 2020-Shtator 2021**. Si pikënisje është marrë raporti alternativ i Avokatit të Popullit për Komitetin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) që shtrihet për periudhën 2016-2020, i cili është dorëzuar pranë Komitetit të Konventës në Gjenevë. Gjetjet e këtij raporti Avokati i Popullit i ka prezantuar në një forum diskutimi online në datën 10 dhjetor 2020, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga Kuvendi i Shqipërisë, institucionet përgjegjëse, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të grave.³

Qëllimi: Raporti synon të evidentojë zhvillimet më të rëndësishme dhe në veçanti problematikat në lidhje me legjislacionin dhe masat e ndërmarra për luftën e dhunës ndaj grave nga institucione të ndryshme, sipas përgjegjësive ligjore dhe institucionale, si dhe të paraqesë rekomandime konkrete. Në raport trajtohet edhe përgjigja e institucioneve për adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje gjatë pandemisë së COVID-19, veçanërisht periudhës së kufizimit të lëvizjes, pasi kjo situatë, ashtu si dhe në vende të tjera në mbarë botën, ndikoi në një rritje të ndjeshme të rasteve të dhunës në familje.

Çështjet: Raporti trajton çështjet e përmirësimit të legjislacionit, masat për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna si dhe ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat.

Metodologjia: Raporti u hartua si një analizë e informacionit të mbledhur nga disa burime. Së pari, Avokati i Popullit u kërkoi me shkrim informacion institucioneve kryesore përgjegjëse për të adresuar dhunën me bazë gjinore në nivel qendror (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policië, Ministria e Drejtësisë, dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit) si dhe 61 bashkive të vendit. Nëpërmjet këtyre shkresave u kërkua informacion i detajuar nga çdo institucion dhe bashki, për masat e marra prej tyre gjatë periudhës (Janar-Dhjetor 2020 dhe Janar-Shtator 2021), sipas

² Raporti është përgatitur me mbështetjen e UN Women, Shqipëri në kuadër të programit të përbashkët të OKB-së në Shqipëri "Për luftën e dhunës ndaj Grave", mbështetur nga Qeveria Suedeze. Por qqëndrimet e shprehura nuk janë opinionet e UN Women, OKB-së apo Qeverisë Suedeze, por vetëm të Avokatit të Popullit.

³ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/SessionDetails1.aspx?SessionID=799&Lang=en;
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Alternative%20report%20on%20implementantion%20of%20Cedaw%20convert%20on%20Albania.pdf>

përgjegjësi të tyre përkatëse (të detajuara për çdo institucion), të parashikuara në legjislacionin për adresimin e dhunës në familje. Po kështu, u përdorën edhe burime të tjera si raporte të organizatave të shoqërisë civile dhe rekomandime të organizatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në këtë fushë, si dhe u zhvilluan vizita monitoruese nga Avokati i Popullit në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje (QKTVDHF) si dhe në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, LILIU.

Në raport janë vlerësuar edhe ankesat apo kërkesat e ardhura në institucionin e Avokatit të Popullit në këtë periudhë.

Avokati i Popullit vlerëson dhe falenderon të gjitha institucionet për kthimin e përgjigjeve, në shumicën e rasteve të detajuara dhe brenda afatit të kërkuar.

Avokati i Popullit, do të vazhdojë komunikimin me institucionet e sipërpërmendura, për tu parashuar drejtpërsëdrejti konstatimet dhe rekomandimet e këtij raporti, si dhe për tu kërkuar informacion plotësues për disa nga çështjet që kërkojnë përgjigje më të plota. Gjithashtu, Avokati i Popullit përfitoi nga kjo mundësi për të risjellë në vëmendjen e institucioneve shqiptare, veçanërisht atyre në nivel vendor, detyrimet që kanë në bazë të legjislacionit të përmirësuar vitet e fundit kundër dhunës me bazë gjinore.

Ne besojmë se përgatitja dhe paraqitja e këtij raporti së bashku me gjithë procedurën në vijim për diskutimin e tij, do të shërbejë si një element i rëndësishëm në luftën kundër dhunës në familje dhe feminicitit në veçanti.

SEKSIONI 1 – LEGJISLACIONI NË FUSHËN E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE

Vitet e fundit, legjislacioni kundër dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe ai penal, janë përmirësuar ndjeshëm, në veçanti kuadri ligjor dhe nënligjor që adreson dhunën në familje. Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur disa nga zhvillimet më të rëndësishme të viteve të fundit, për të cilat përgëzohen përpjekjet e Qeverisë (në veçanti Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë), Kuvendit, si dhe shoqërisë civile që ka kontribuar nëpërmjet sugjerimeve nisur nga eksperiencia konkrete e organizatave që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe ato me bazë gjinore.

Evidentimi dhe trajtimi i rasteve është karakterizuar me marrjen e masave legislative në mënyrë progresive dhe praktike, çka tregon rëndësinë që i kanë dhënë çështjes të tërë aktorët në vend.

1.1 Legjislacioni kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunën me bazë gjinore

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, qëllimi i të cilit është të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, si dhe të sigurojë më shumë mbrojtje për viktimat, ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitet 2018 (ligji 47/2018) dhe 2020 (Ligji 125/2020), duke përmbushur disa nga rekomandimet kyçe të Komitetit CEDAW (2016) dhe GREVIO (2017)

për Shqipërinë. Njëpërmjet ndryshimeve të vitit 2018, u zgjeruan dhe u qartësuan përgjegjësitë e institucioneve për të forcuar masat mbrojtëse dhe procedurat për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Gjithashtu, për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesa.

Ndërkohë, që ndryshimet e vitit 2020⁴ e përmirësuan kuadrin ligjor në disa drejtime si: theksimi i vëmendjes së veçantë ndaj grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, urdhërimin nga gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, për largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë; shtimi i nenit për rehabilitimin e dhunuesve; përfshirja në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, të largimit të menjëhershëm të dhunuesit nga banesa, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara - derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes; aplikimi nga policia i kërkesës drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, nëse në vend është shpallur situatë e gjendjes së jashtëzakonshme, etj.

Në zbatim të ligjeve Nr. 47/2018 dhe Nr. 125/2020 janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore, ndër të cilat theksojmë:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”;
- Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) në fushën e shëndetësisë dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror (shkurt 2020);
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 9, datë 17.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”;
- Udhëzimi Nr. 816, datë 27.11.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të Qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”;
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”;
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”.

⁴ Ligji nr 125 datë 15.10.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar

Po ashtu, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë kanë hartuar dhe shpërndarë një sërë dokumentacioni (Letra Porosie) drejtuar Komisariateve të Policisë në të gjithë vendin për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Gjatë vitit 2020, u morrën masa për përmirësimin e kuadrit nënligjor, edhe për t'iu përgjigjur situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19 dhe në veçanti rritjes së rasteve të dhunës në familje si pasojë e masave të kufizimit të lëvizjes së shtetasve. Sipas informacioneve nga organizatat që punojnë në këtë fushë, kjo rritje e numrit të raportimeve të dhunës ndodhi jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën, si pasojë e izolimit të viktimave me dhunuesit. Në këtë drejtim, janë miratuar disa akte nënligjore të rëndësishme, përfshirë:

- Protokoli i MSHMS nr. 254, datë 10 prill 2020 " Për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit në situatën e pandemisë COVID-19".
- Udhëzimi i MSHMBS Nr. 253, datë 10 Prill 2020 "Për menaxhimin e rasteve që përfshijnë fëmijët në nevojë për mbrojtje gjatë urgjencës COVID-19"
- Akti Normativ i Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 25 Mars 2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"

Është për tu vlerësuar fakti që eksperiencia e pandemisë solli një ndërgjegjësim të organeve ligj-bërëse dhe ligj-zbatuese edhe për përmirësimin e kuadrit ligjor të dhunës në familje, për të siguruar një përgjigje efektive të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare, kur në territorin e vendit, ose një pjesë të tij janë vendosur masa të jashtëzakoshme (ndryshimet e Ligjit për DHF të vitit 2020).

1.2 Legjislacioni penal

Kodi Penal pësoi një amendim shumë të rëndësishëm në këtë fushë, me miratimin e Ligjit nr 35 datë 16.04.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ndryshimi kryesor konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike në marrëdhëniet familjare si dhe përfshirja në këto marrëdhënie të personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, duke harmonizuar përmbajtjen e nenit 130/a të Kodit Penal me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet e vitit 2018 në ligjin për dhunën në familje.

Konstatime - Aspekte ligjore që duhen përmirësuar

Pavarësisht ndryshimeve pozitive të mësipërme, kuadri ligjor në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Disa aspekte të rëndësishme në këtë drejtim mbeten:

- Nevoja për hartimin e një kuadri ligjor që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore – krahas dhunës në familje - si ngacmimi dhe dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyrueshme, etj. Ndonëse këto forma dhune janë të përfshira si vepra penale në Kodin Penal, mungon një kuadër ligjor që të rregullojë marrjen e masave administrative dhe gjyqësore për parandalimin, mbrojtjen e viktimave dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara,

sikurse ekzistojnë për dhunën në familje. Për shembull, nëse një person përndiqet nga dikush me të cilin nuk është në një lidhje familjare ose intime, ndonëse në bazë të legjislacioni penal mund të fillojë një procedim penal ndaj ngacmuesit, mungojnë mjete ligjore të qarta për të siguruar masa të përkohshme mbrojtje (urdhër mbrojtjeje), si dhe ofrimi i shërbimeve të specializuara, sikurse është rasti për dhunën në marrëdhëniet familjare. Një kuadër ligjor më i plotë duhet të adresojë edhe format e dhunës në internet, kryesisht të natyrës psikologjike, të cilat janë mjaft të përhapura në shoqërinë shqiptare dhe mbarë botën.

Në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit zhvilloi në vitin 2019 tryezën e parë të konsultimit për hartimin e një ligji të integruar kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Diskutimi u fokusua mbi nevojën e hartimit të një ligji të integruar kundër dhunës ndaj grave e vajzave sipas Standarteve të Konventës së Stambollit për ndalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe masat përkatëse që duhet të merren nga të gjithë institucionet shtetërore, institucionet e pavarura që monitorojnë të drejtat e njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile, në vijim të punës së tyre të përbashkët për përmirësimin e masave legjislative kundër dhunës me bazë gjinore.

Miratimi i një ligji ose kuadri ligjor që të rregullojë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, është edhe një nga rekomandimet kyçe të Komitetit të GREVIOs, ⁵drejtuar Shqipërisë që në vitin 2017 dhe haset edhe në rekomandimet e mëtejshme të mekanizmave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Mekanizmin Universal të të Drejtave të Njeriut të OKB-së (UPR).⁶

- Ndryshime ligjore ose nënligjore për të siguruar mënyra alternative për zbatimin e detyrimeve ligjore, që për momentin janë të pamundura për shkak të mungesës së disa shërbimeve, psh. detyrimi i parashikuar në nenin 10/1 të ligjit nr. 125/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në bazë të të cilit gjykata duhet të urdhërojë dhunuesin, në urdhrin e mbrojtjes, të ndjekë programe rehabilitimi, është praktikisht i pamundur në pjesën më të madhe të bashkive të vendit. Aktualisht ky shërbim ofrohet vetëm në dy bashki (Tiranë dhe Shkodër). Afati për ngirtjen e qendrave rehabilituese në të 12 qarqet e vendit gjatë periudhës 2026-2031 në Strategjinë e re të Barazisë Gjinore (2021-2031) është tejte i gjatë dhe e bën praktikisht të pamundur që gjykata të zbatojë këtë detyrim për vite me radhë. Në këto kushte, Avokati i Popullit sugjeron ndryshime ligjore ose nënligjore që të mundësojnë organizimin e rehabilitimit edhe në distancë ose online nga qendrat ekzistuese, një praktikë që po ndiqet në shume fusha edhe në kuadër të kontekstit të pandemisë së Covid-19.
- *Nevoja për të ndryshuar përkufizimin e veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë (si për madhorët ashtu edhe të miturit) në Kodin Penal, në përputhje me Konventën e Stambollit.* Përkufizimi aktual në legjislacionin shqiptar kërkon provimin e përdorimit të forcës dhe si

⁵ Raporti i parë i Vlerësimit të GREVIOs për Shqipërinë, 2017, para. 2-4 <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

⁶ Universal Periodic Review - Albania , <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALindex.aspx>

rrjedhim, viktima ka barrën për të provuar dhunën dhe rezistencën. Por, nëse viktima e ka të vështirë ose të pamundur të shfaqë rezistencë, kjo mund të çojë në raste përdhunimi të paraportuara ose të pa ndjekuara penalisht.

Legjislacioni ndërkombëtar (Konventa e Stambollit) kërkon që Shtetet Palë ta bazojnë përkufizimin e kësaj vepre penale në mungesën e shprehur të pëlqimit për kryerjen e marrëdheneve seksuale për tu cilësuar si e tillë. Kjo është një praktikë që ka ndryshuar dhe po ndryshon në disa vende evropiane, në përputhje me Konventën e Stambollit, e cila pas ratifikimit, në bazë të Kushtetutës, është bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm dhe ka përparësi ndaj akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që bien ndesh më të. Po ashtu, edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ndjek të njëjtin parim, ku me rëndësi është çështja M.C. v Bullgarisë, ku Gjykata është shprehur: “Një qasje e ngurtë e ndjekjes penale të krimeve seksuale, si ajo që kërkon provë për rezistencë fizike në të gjitha rrethanat, rrezikon të bëjë që disa forma të përdhunimit të mos ndiqen penalisht, duke rrezikuar kështu mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individëve.”⁷

- Po ashtu, sipas sugjerimeve të GREVIOs, Kodi Penal, duhet të ndryshohet në drejtim të përkufizimit të masave ndëshkuese në lidhje me martesat e detyrueshme, si dhe përfshirjen si vepra penale të sterilizimit të detyrueshëm dhe gjymtimi gjenital, të dy këto krime me natyrë seksuale, të parashikuara si të tilla nga Konventa e Stambollit.

Avokati i Popullit vlerëson pozitivisht ndryshimet ligjore që kanë ndodhur vitet e fundit në lidhje me përmirësimin e legjislacionit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Por institucioni ynë sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të tij, në bazë të standarteve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të mekanizmave rajonale dhe botërorë të të drejtave të njeriut.

Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit konsideron shumë të rëndësishme marrjen e masave për zbatimin me efektivitet të legjislacionit të përmirësuar, pa të cilat nuk mund të sigurohet parandalimi i dhunës dhe mbrojtja e viktimave. Këto masa duhet të përfshijnë, ndër të tjera, njohjen e mirë të legjislacionit nga autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, investime për rritjen e kapaciteteve teknike të tyre, dhe në veçanti rritjen e burimeve njerëzore dhe financiare për zbatimin e masave ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto masa do të diskutohen në seksionet e mëposhtme.

SEKSONI 2: MBROJTJA E GRAVE DHE VAJZAVE NGA DHUNA

Ky seksion trajton çështje që kanë të bëjnë me raportimin, masat mbrojtëse, zbatimin dhe monitorimin e tyre; ndihma ligjore për gratë e dhunuara dhe ndëshkimi i dhunuesve, përfshirë dhe programet e rehabilitimit.

⁷ Paragrafi 161, MC k. Bullgarisë, GJEDNJ, 2014, https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/resources/M.C.v.BULGARIA_en.asp

2.1 Raportimi i dhunës

Në Shqipëri ekzistojnë disa mënyra për raportimin e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore. Avokati i Popullit vëren se Policia mbetet një nga institucionet më të besueshme për raportimin e dhunës. Sipas Drejtorisë së Policisë:

- gjatë **vitit 2020** janë evidentuar dhe trajtuar nga policia, gjithsej **4701** raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare - 72 raste me shumë, ose 1.5% më shumë, se gjatë vitit 2019, ku u evidentuan 4629 raste.
- gjatë periudhës **1 janar – 30 shtator 2021** janë evidentuar dhe trajtuar nga policia, gjithsej **3997** raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, ose 404 raste me shumë, ose 11.24 % më shumë, se gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2020, ku u evidentuan 3593 raste.

Por, të dhënat nga burime të tjera nuk përkojnë me të dhënat e Drejtorisë së Policisë. Kështu, sipas të dhënave të Mekanizmave të Referimit të dhunës në nivel vendor, nëpërmjet sistemit REVALB: **për vitin 2020: 40** bashki kanë hedhur të dhënat në sistem dhe i kanë përditësuar, nga ky rezultojnë **1003** raste të dhunës në familje. Për periudhën **janar-shtator 2021: 38** bashki kanë hedhur të dhënat në sistem dhe i kanë përditësuar, nga ku rezultojnë **943** raste të dhunës në familje.

Nga ana tjetër në **Linjën Kombëtare të Këshillimit 116 117 (Linja)** numri i rasteve të denoncuar/evidentuara dhe të trajtuara nga kjo linjë për raportim dhune në vitin **2020 ishte 5597** dhe për periudhën **Janar – Shtator 2021 ka patur 2476** telefonata në total. (Informacion më i detajuar për linjën gjendet në seksionin e dytë të këtij raporti)⁸.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson krizimin e disa mënyrave për tu mundësuar viktimave të dhunës raportimin dhe marrjen e mbështetjes së nevojshme, përfshirë edhe aplikacionin digital Bright Sky, në bashkëpunim me Fondacionin Vodafone Albania. Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se ka një rritje ndër vite të rasteve të raportuara të dhunës, që nuk interpretohet domosdoshmërisht vetëm si rritje të fenomenit të dhunës, por edhe rritje e besimit të viktimave tek autoritetet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile. Kjo pasi, prevalenca e dhunës me bazë gjinore, që nuk mund të vlerësohet vetëm nëpërmjet raportimeve zyrtare, ka qënë relativisht e lartë në Shqipëri ndër vite, përfshirë vitet e fundit dhe shumë herë më e lartë se numri i raportimeve

Në bazë të Vrojtimit më të fundit kombëtar të zhvilluar nga INSTAT në vitin 2019, 1 në 2, apo 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç, kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës gjatë jetës së tyre - dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim, dhuna gjatë marrëdhënieve dashurore, dhuna nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe, përndjekja. Më konkretisht, 47,0% e grave (ato

⁸ Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, është një organizatë jofitimprurëse, e cila ofron shërbime të këshillimit, denoncimit dhe referimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore, i bazuar edhe në VKM Nr.150, datë 20.03.2019, “Për Metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social”, pika 2, nëpërmjet marrëveshjes ndërmjet MSHMS-në dhe Këshillit të Qarkut Tiranë dhe është është përfitues i Fondit Social.

që ishin apo kishin qenë të martuara dhe/ose jetonin me një partner) kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje nga partneri intim, dhe 65,8% e grave (ato që nuk ishin martuar ndonjëherë dhe që nuk kishin jetuar ndonjëherë me një partner mashkull, por që janë përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull pa jetuar së bashku) kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë gjatë marrëdhënieve dashurore. Ndër të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 18,2% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga jopartneri, 18,1% kanë përjetuar “ndonjëherë” ngacmim seksual dhe, 12.6% kanë përjetuar “ndonjëherë” përndjekje. Po ashtu, Në lidhje me përjetimet aktuale të dhunës, 1 në 3 gra, ose 36,6% e grave kanë përjetuar dhunë gjatë 12 muajve përpara vrotimit. Në veçanti, 1 në 3 gra, ose 33,7% e grave kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim dhe 61,8% kanë përjetuar dhunë gjatë marrëdhënieve dashurore gjatë 12 muajve përpara vrotimit. Nga të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 3,4% kanë përjetuar dhunë nga jopartneri, 8,5% kanë përjetuar ngacmime seksuale dhe 6,9% kanë përjetuar përndjekje në 12 muajt përpara vrotimit.

Gjatë periudhës së pandemisë dhe në veçanti të masave kufizuese të lëvizjes, niveli i dhunës u rrit ndjeshëm në Shqipëri, sikurse edhe në të gjitha vendet e tjera të botës për shkak të izolimit të viktimeve në të njëjtin ambient me dhunuesit për një kohë të gjatë. Gjatë periudhës (Mars-Maj 2020), numri i thirrjeve pranë Linjës 116 117 ishte trefish më i lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërkohë që numri i raportimeve pranë policisë ishte më i ulët se në të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në lidhje me çështjen e raportimeve, Avokati i Popullit vëren dhe sugjeron:

- Nevojën për një koordinim më të mirë të Mekanizmave të Referimit të Dhunës në nivel lokal me strukturat e policisë për të referuar në mënyrë të ndërsjelltë rastet e dhunës në familje dhe formave të tjera dhe për tu ofruar viktimeve të gjitha shërbimet e nevojshme. Mospërputhja e numrave ndërmjet këtyre strukturave tregon se shumë viktime të dhunës nuk përfitojnë shërbimet për të cilat kanë të drejtë në nivelin vendor.
- Zgjerimin e fushatave ndërgjegjësuese për raportimin e dhunës në të gjithë vendin, si një mënyrë efektive për të bërë viktimat të thyejnë ciklin e dhunës dhe të marrin ndihmën e nevojshme. Rritja e raportimeve do të sigurojë edhe më tepër mbrojtje nga format më ekstreme të dhunës, vrasjet, të cilat gjithashtu kanë pësuar një rritje në vendin tonë. Kështu në vitin 2020, nga 52 vrasje me dashje rreth 13,5 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c).
- Shoqërimin e fushatave ndërgjegjësuese me programe për rritjen e kapaciteteve të strukturave ku raportohet dhuna, për tu ofruar viktimeve të dhunës, mbështetjen e menjëhershme psikosociale e ligjore, si dhe shmangien e veprimeve që mund të sjellin stigmatizimin e denoncueseve të dhunës.
- Marrjen e masave për shtrirjen e Linjës së Këshillimit, ose krijimin e strukturave të ngjashme në të gjithë vendin, në veçanti në zonat e thella rurale, si dhe për gratë nga grupet e pafavorizuara, si gratë me aftësi të kufizuara, ato nga komuniteti Rom, gratë e moshuara, LBT, të cilat mund të mos kenë informacionin dhe aksesin në teknologji për të raportuar dhunën. Këto linja, në të gjithë botën, janë një nga mënyrat më efektive për të mbështetur psikologjikisht viktimat gjatë përjetimit të dhunës dhe krijimin e mundësive për raportimin e saj tek autoritetet.
- Ndërgjegjësimin e gjithë autoriteteve përgjegjëse (institucionet që në bazë të ligjit 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar) kanë detyrimin t’i

përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, për rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrimit të mbrojtjes apo urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në veçanti, sektorët e shëndetësisë dhe arsimit duhet të rrisin përpjekjet për të identifikuar dhe mbështetur viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. (Më tepër informacion për këta sektorë gjendet në seksionin 2 të këtij raporti).

- Vënien përpara përgjegjësisë të personave të cilët marrin dënim për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, në përputhje me nenin 8, paragrafi 5, i ligjit për dhunën në marrëdhëniet familjare, i cili i ngarkon këto autoritete me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.
- Aktivitetet ndërgjegjësuese kundër dhunës me bazë gjinore duhet të organizohen vazhdimisht përgjatë vitit dhe të mos kufizohen vetëm gjatë fushatave specifike, si psh fushata ndërkombëtare e 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.

2.3 Vlerësimi i riskut për rastet e dhunës në familje

Ndryshimet e vitit 2018 në legjislacionin e dhunës në familje rregulluan për herë të parë procedurat e vlerësimit të riskut, në përputhje me standartet e Konventës së Stambollit. Ky hap është një nga aspektet më të rëndësishme të procesit të menaxhimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore dhe orienton organet gjyqësore për marrjen e masave më të përshtatshme për mbrojtjen e viktimës dhe shmangien e dhunës së mëtejshme. Në zbatim të ndryshimeve ligjore për dhunën në familje, janë miratuar një Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”⁹, si dhe një Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrimit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”¹⁰.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë informon se në përgjithësi ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet organeve të policisë dhe koordinatorëve vendor të dhunës për menaxhimin e riskut. Ndërkohë, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informojnë për një sërë trajnimesh për organet e policisë në drejtim të masave mbrojtëse, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Kohët e fundit është bërë një vlerësim i mënyrës së plotësimit të raporteve të vlerësimit të riskut nga ana e punonjësve të policisë dhe bashkëpunimi i tyre me koordinatorët vendorë për Drejtorinë Vendore të Policive Elbasan dhe Kukës. Gjetjet nga ky raport u përdorën për të përmirësuar kapacitetet e punonjësve të policisë në një cikël trajnimesh që ka filluar nga muaji shtator 2021 dhe që do të vijojnë edhe përgjatë fundit të këtij viti dhe fillimit të viti 2022.¹¹

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson se kuadri ligjor shqiptar (në veçanti pas vitit 2018) është përmirësuar ndjeshëm për sa i përket procedurave dhe kritereve për vlerësimin e riskut dhe marrjen e masave mbrojtëse dhe parandaluese. Trajnimi i punonjësve të policisë dhe gjithë aktorëve të tjerë të

⁹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 204, të vitit 2018, publikuar në 26 shkurt 2019

¹⁰ Po aty.

¹¹ Gjatë muajit shtator 2021 dhe dhjetorit të parë të muajit tetor u organizuan trajnime vlerësimin e riskut dhe bashkëpunimin e policisë me antarët e tjerë të MKR-së për rreth 180 punonjëse dhe punonjës policie në Durrës, Gjirokastër dhe Berat.

përshirë është i rëndësishëm dhe Avokati i Popullit vlerëson aktivitetet trajnuese. Por, institucioni ynë vëren se:

- zbatimi i këtyre procedurave nga të gjitha institucionet e përfshira dhe në të gjithë territorin e vendit ka nevojë të përmirësohet ndjeshëm, duke qenë se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë e miratimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse (që në vitin 2018). Një grup organizatash të shoqërisë civile që kanë realizuar një monitorim më specifik të kësaj çështjeje theksojnë se gjatë periudhës 2018-2020 nuk ka pasur procedura të konsoliduara në lidhje me vlerësimin e riskut dhe lëshimin e Urdhërave për Marrjen e Masave Paraprake të Menjëhershëm (UMMPM). Në disa stacione policie të monitoruara për këtë qëllim, nuk kishte filluar ende zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore për vlerësimin e riskut, ose në disa të tjera organet e policisë nuk ishin të qartë sesi duhet të procedonin me lëshimin e UMMPM pas vlerësimit të riskut. Probleme janë identifikuar edhe me bashkëpunimin me koordinatorët lokalë të dhunës në familje, ku në disa raste nuk ishin njoftuar për vlerësimin e riskut, apo të merrnin pjesë në këtë procedurë, që është një nga aspektet më të rëndësishme të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje.¹²
- Avokati i Popullit sugjeron marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e procedurave të miratuara të vlerësimit të riskut në të gjithë vendin dhe përshpejtimin e programeve trajnuese për punonjësit e policisë nga vetë institucionet shqiptare, krahas mbështetjes që ofrohet nga organizatat ndërkombëtare.
- Një rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet kontrollit të zbatimit të procedurave të vlerësimit të riskut dhe lëshimit të UMMPM nga strukturat mbikqyrëse përkatëse dhe evidentimin periodik të problemeve që shfaqen në praktikë.

2.3 Masat Mbrojtëse

Në bazë të ligjit 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar ekzistojnë tre forma të urdhërave mbrojtëse për viktimat:

- Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPM), që nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna, i cili brenda 48 orëve ia paraqit Gjykatës për vlerësim të bashku me kërkesëpadinë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.
- Urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM), i cili lëshohet nga gjykata duke parashikuar një ose disa nga masat mbrojtëse ligjore; dhe
- Urdhrit të mbrojtjes (UM) që lëshohet për një periudhë afatgjatë, jo më vonë se 20 ditë nga lëshimi i UMM.

Vendimet për UMM dhe UM janë tituj ekzekutivë dhe ekzekutohen menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njesisë

¹² Raporti Hije mbi Zbatimin e Rekomandimeve të adresuara Shqipërisë nga Komiteti i Palëve në Konventën e e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), për periudhën 2018-2020, Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Baze Gjinore, 2021, https://rm.coe.int/albania-report-the.../1680a4681f?fbclid=IwAR2T4ojuXE-YSNKYs5b7w5f-i0I4A_ExOwdG_jtGVEakk61rNpzTZhD4p-o

vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Drejtoria e Policisë informon:

- Gjatë vitit **2020** janë trajtuar me kërkesëpadi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”, 2816 raste të dhunës në familje, ose 20 raste më pak të trajtuara me kërkesëpadi, se gjatë vitit 2019, ku janë trajtuar 2836 raste. Janë evidentuar 138 raste të shkeljeve të Urdhrave të Mbrojtjes, ku autorët janë proceduar penalisht, sipas neneve 321 dhe 130/a të Kodit Penal.¹³
- Gjatë **periudhës 1 janar – 30 shtator 2021** janë trajtuar me kërkesëpadi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”, **2495 raste** të dhunës në familje, ose **362 raste ose 16.97% më shumë** të trajtuara me kërkesëpadi, se gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2020, ku janë trajtuar **2133 raste**. Janë evidentuar **119 raste** të shkeljeve të Urdhrave të Mbrojtjes, ku autorët janë proceduar penalisht, sipas neneve 321 dhe 130/a të Kodit Penal.

Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë, sipas të dhënave të Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror informon:

- Gjatë vitit **2020** janë regjistruar gjithësej 566 tituj ekzekutivë mbrojtje nga të cilët 189 “Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe 339 “Urdhër i Mbrojtjes”;
- Gjatë periudhës **Janar-30 shtator 2021** janë regjistruar gjithësej 608 tituj ekzekutivë mbrojtje nga të cilët 374 “Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe 234 “Urdhër i Mbrojtjes”;

Sipas Ministrisë së Drejtësisë ka një nivel të lartë të ekzekutimit të këtyre UMM dhe UM, ku një pjesë e çështjeve janë ekzekutuar dhe një pjesë janë në ekzekutim të mëtejshëm. Megjithatë, ky institucion vë në dukje vështirësitë lidhur ngarkesën e lartë të numrit të çështjeve dhe mungesës së një raporti normal midis dosjeve përbarimore dhe numrit të përbaruesve gjyqësor. Gjithashtu problematike është paqartësia e vendimeve të gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse, ose rastet kur është vendosur largimi i dhunuesit nga banesa dhe është ngarkuar Shërbimi Social pranë pushtetit vendor për të gjetur strehim për dhunuesin, të cilat paraqesin vështirësi për tu zbatuar për shkak se pushteti vendor nuk ka mundësi për strehim alternativ.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e Drejtorisë së Policisë për të paraqitur kërkesëpadi për UMM dhe UM si dhe Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e titujve ekzekutivë UMM/UM. Megjithatë, ky institucion vëren se:

- Mungon informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për numrat dhe zbatueshmërinë e urdhrave për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM);
- Paraqet vështirësi zbatimi i masës mbrojtëse të largimit të dhunuesit nga vendbanimi i përbashkët me të dhunuarën, kur kjo parashikohet në urdhërat e mbrojtjes. Avokati i Popullit thekson se ndryshimet ligjore të vitit 2020, e parashikojnë largimin e dhunuesit si masën e parë dhe kryesore

¹³ Nuk ka të dhëna zyrtare për fatin e këtyre procedimeve.

që duhet të merret nga Gjykatat kur dhunuesi dhe i dhunuari/e dhunuar banojnë në një strehë të përbashkët dhe gjithashtu si masa e parë në urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme që lëshohen nga policia, derisa gjykata të lëshojë urdhërin e përkohshëm të mbrojtjes. Në këtë drejtim, organet gjyqësore dhe ligjzbatuese duhet të udhëhiqen nga parimi i interesit më të lartë të viktimës dhe jo i interesit (apo vështirësive për akomodim alternativ) të dhunuesit. Interesi, siguria dhe mbrojtja e jetës dhe sigurisë fizike dhe psikologjike të viktimës, duhet të jenë prioritetet kryesore.

- Ka shumë vështirësi për zbatimin me rigorozitet të UMM dhe UM dhe për të siguruar mbrojtje efiksase, edhe si mungesë e burimeve njerëzore që pranohet vetë nga Ministria e Drejtësisë, megjithë numrin shumë më të vogël të vendimeve-tituj ekzekutiv për këto raste, në krahasim me një numër disa herë më të madh raportimesh nga të dhunuarat/të dhunuarit dhe kërkesë-paditë për lëshimin e UM/UMM.
- Ka nevojë të domosdoshme për bashkëpunim të vazhdueshëm të zyrave lokale të përmbartimit gjyqësor, organeve të policisë dhe njësive vendore/koordinatorët e dhunës në familje për të siguruar zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.
- Po ashtu, duhet të organizohen trajnime të vazhdueshëm të punonjësve të përmbartimit, në lidhje me legjislacionin kundër dhunës me bazë gjinore dhe masave mbrojtëse, një sfidë që ngrihet vetë nga Ministria e Drejtësisë, por për të cilin ka vetë gjithashtu detyrimin për ta adresuar.
- Të dhënat e mësipërme nuk janë të publikuara në mënyrë që të mundësohet që të kemi ndërgjegjësimi për egzistencën e mekanizmave dhe efikasitetin e tyre. Veçanërisht me rëndësi do të ishte identifikimi dhe publikimi i dënimeve për shkeljen e urdhërave të mbrojtjes.

2.4 Monitorimi i Urdhrave të Mbrojtjes

Në bazë të nenit 23 të ligjit 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, paragrafi 3/1, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të monitorojë respektimin e urdhrat të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë të përgatisë një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

Në lidhje me këtë kërkesë ligjore, Avokati i Popullit u kërkoi të gjitha bashkive të vendit të informonin mbi masat e ndërmarra dhe bashkëpunimin me Policinë për këtë detyrim ligjor dhe në përgjithësi, pjesa më e madhe e bashkive u përgjigjën në mënyrë të përgjithshme që e zbatonin detyrimin e monitorimit dhe dërgimin e raporteve, por shumë prej tyre pa dhënë informacion të detajuar mbi numrin e rasteve të monitoruara dhe për të cilat kishin përgatitur dhe dërguar pranë sektorëve përkatës të policisë raporte (me përjashtim të bashkisë së Tiranës, Shkodrës dhe Delvinës që paraqitën të dhëna dhe më shumë detaje). Nga ana tjetër, Drejtoria e Policisë së Shtetit informoi se pavarësisht bashkëpunimit të mirë me koordinatoret vendor kundër dhunës në familje përsa i përket referimit dhe trajtimit të përbashkët të rasteve të dhunës dhe hartimit të vlerësimit të rrishtit, asnjë rast nga ana e autoriteteve lokale të shërbimit social nuk është zbatuar detyrimi ligjor për vënien në dispozicion të policisë të një raporti mbi monitorimin

e zbatimit të UM/UMM. Punonjësit e policisë, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të UM/UMM, në vazhdimësi marrin takim me viktimat e dhunës dhe autorët e saj, me qëllim informimin për detyrimet e palëve për zbatimin e UM/UMM, organizojnë patrullime më të shpeshta në zonat ku jetojnë persona me UM/UMM, si dhe viktimave u këshillohet të telefonojnë menjëherë punonjësin e policisë përgjegjës apo në numrin pa pagesë 112/129, në rastet kur konstatojnë se dhunuesi është në shkelje të masave mbrojtëse.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përmirësimet ligjore të viteve të fundit që kanë të bëjnë me shtimin dhe përfundimin e masave mbrojtëse për viktimat e dhunës dhe në veçanti përpjekjet e Policisë së Shtetit që mbetet një nga institucionet më të besueshëm për tu drejtuar nga viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, Avokati i Popullit vëren:

- Një diferencë të madhe ndërmjet raportimeve në polici dhe kërkesëpadive për marrjen e masave të mbrojtjes me numrin e vendimeve për UM/UMB aktualë që lëshohen nga gjykatat, që mund të jetë pasojë e disa faktorëve. Avokati i Popullit sugjeron një monitorim më specifik mbi këta faktorë nga institucionet përgjegjëse mbikqyrëse, përfshi Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, i cili në bazë të Ligjit 15/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” mund të ndërmarrë inspektime institucionale dhe tematike mbi çdo aspekt të praktikës gjyqësore.
- Nevojën për përfshirjen dhe bashkëpunimin e organeve të pushtetit vendor (shërbimet sociale, koordinatorët kundër dhunës në familje etj) për monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me detyrimin ligjor që kanë dhe mbajtjen e përgjegjësisë për mospërmbyshjen e këtij detyrimi.
- Ndjekjen e mëtejshme dhe sqarimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, komisarivateve lokale dhe bashkive për mospërputhjen e informacionit të dërguar nga Drejtoria e Policisë dhe bashkive për raportet e monitorimit të UM/UMM.
- Organizimin e trajnimeve për përmbauesit gjyqësor në lidhje me legjislacionin kundër dhunës me bazë gjinore. Kjo kërkesë vjen edhe nga Ministria e Drejtësisë, e cila në shkresën e saj thekson mungesën e trajnimeve për këta punonjës në lidhje me ndryshimet ligjore të viteve të fundit në këtë fushë.
- Publikimin e të dhënave për të rritur ndërgjegjësimin për efektivitetin e sistemit të mbrojtjes.

2.5 Vrasjet dhe ndjekja penale e dhunuesve

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë informon:

Gjatë vitit **2020**:

- kanë ndodhur dhe evidentuar 6 vrasje në marrëdhëniet familjare (neni79/c) me 7 viktima, ndërsa gjatë vitit 2019 kanë ndodhur 14 vrasje me 17 viktima. (Sipas INSTAT këto përbëjnë rreth 13,5 % të numrit total të vrasjeve me dashje¹⁴). Gjatë vitit 2020 kanë ndodhur 57% më pak vrasje se gjatë vitit 2019.

¹⁴ Burra dhe Gra, 2020, INSTAT, <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografikë-dhe-socialë/barazia-gjinore/publikimet/2021/gratë-dhe-burra-në-shqipëri-2021/>

- Janë referuar materialet në Prokurori, bazuar në nenin 130/a, për 1505 raste të dhunës në familje, ose 164 raste më shumë, ose 12.2% më shumë se gjatë vitit 2019, ku janë referuar për 130/a, 1341 raste. Sipas INSTAT, janë dënuar me vendim gjyqësor për këtë vepër penale 1604 persona (1476 burra dhe 128 gra)¹⁵.
- Janë arrestuar 615 autorë për dhunë në famije (130/a) dhe janë ndaluar 111 prej tyre. Në krahasim me vitin 2019, kur u arrestuan 535 autorë, gjatë vitit 2020 janë arrestuar 80 autorë ose 15% më shumë autorë të arrestuar.

Gjatë periudhës 1 janar – 30 shtator 2021:

- Kanë ndodhur dhe evidentuar 15 vrasje në marrëdhëniet familjare (neni79/c) me 15 viktime, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2020, kanë ndodhur 6 vrasje me 7 viktime.
- Janë referuar materialet në Prokurori, bazuar në nenin 130/a, për 1200 raste të dhunës në familje, ose 34 raste më shumë, ose 2.91% më shumë se gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2020, ku janë referuar për 130/a, 1166 raste.
- Janë arrestuar 441 autorë për dhunë në famije (130/a) dhe janë ndaluar 93 prej tyre. Në krahasim me të njëjtës periudhë të vitit 2020, kemi 47 autorë të arrestuar më pak kur u arrestuan 488 autorë.

Ministria e Drejtësisë nuk ka dërguar informacion për masat rehabilituese të dhunuesve. Më tepër informacion në këtë drejtim paraqitet në seksionin 3 të këtij raporti, në bazë të informacionit të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Konstatime:

- Avokati i Popullit konstaton me keqardhje se numri i vrasjeve në marrëdhëniet familjare mbetet shumë i lartë dhe shumica dërmuese e tyre janë gra (88,9% në vitin 2020, sipas INSTAT). Vrasja e grave në marrëdhëniet familjare duhet trajtuar si femicid. Sipas OKB-së, femicidi nënkupton në përgjithësi, vrasjen e qëllimshme të grave sepse janë gra, dhe zakonisht kryhet nga burrat, por mund të përfshijë edhe gra anëtare të familjes. Femicidi ndryshon nga vrasjet e tjera në mënyrë specifike. Për shembull, shumica e vrasjeve kryhen nga partnerë ose ish-partnerë dhe paraprihet nga abuzime të gjata në familje, kërcënime, dhunë fizike dhe seksuale ose situata ku gratë kanë më pak pushtet dhe më pak burime se partnerët e tyre. Për këtë arsye, është e nevojshme që vrasja e grave në marrëdhëniet familjare të trajtohet në gjithë kompleksitetin e saj dhe theksi të vihet në nevojën për arritje më të madhe të barazisë gjinore në shoqëri dhe veçanërisht masave parandaluese.
- Zbatimin me rigorozitet të procedurave të vlerësimit të riskut në momentin e parë që raportohet apo konstatohet dhunë në marrëdhëniet familjare, për të ofruar menjëherë masa mbrojtëse të përshtatshme që shmangin vrasjet dhe format e tjera të dhunës në familje, në veçanti largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga streha e përbashkët.

¹⁵ Numri i të dënuarve mund të jetë më i lartë nga numri i referuar në Prokurori, pasi dënimet në muajt e parë të vitit mund të jenë dhënë për raportimet në vitin paraardhës (2019).

- Nevojën për vënien para përgjegjesisë penale dhe administrative të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar vrasje në marrëdhëniet familjare ose dëmtime të rënda.
- Nevoja për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve mbikqyrëse të sistemit të drejtësisë për të trajnuar dhe monitoruar vendimet e gjykatës për masat mbrojtëse, në të cilat në bazë të ndryshimeve të vitit 2020, të ligjit për dhunën në marrëdhëniet familjare është parashikuar se në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, urdhërohet dhunuesi të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimi prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private.

2.6 Krijimi i sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje, pranë drejtorive të policisë dhe trajnimet për stafin e Policisë

Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë informojnë se është rritur numri i punonjësve të policisë që trajtojnë çështjet e dhunës në familje si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Në çdo komisarjat Policie, në varësi të territorit që mbulojnë dhe numrit të ngjarjeve të evidentuara, janë shtuar 1 deri 3 funksione organike “Specialist për hetimin e krimeve dhe për të miturit e dhunës në familje”. Po ashtu, janë organizuar edhe trajnime për stafin policor në Drejtoritë Vendore të Policisë, kryesisht me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Drejtoria e Policisë informon se vëmendje i është kushtuar edhe masave mbrojtëse nga organet e policisë gjatë periudhës së pandemisë së COVID 19, në veçanti gjatë periudhës së kufizimeve të lëvizjes, nëpërmjet udhëzimeve dhe akteve nënligjore të miratuara për të adresuar dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet për rritjen e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve për stafin e policisë, i cili është një nga sektorët kryesorë për parandalimin dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore. Në të njëjtën kohë Avokati i Popullit vëren se:

- Legjislacioni për dhunën me bazë gjinore ka pësuar ndryshime të rëndësishme dhe komplekse që kërkojnë trajnime të vazhdueshme për personelin që angazhohet në parandalimin dhe marrjen e masave mbrojtëse për viktimat.
- Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë, brenda mundësive, mund të angazhojnë edhe një numër më të madh punonjësish për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në veçanti në zonat e mbipopulluara ose që njihen për ritme më të larta të dhunës me bazë gjinore ose dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Ndërkohë mbetet evidente nevoja për rritjen e kapaciteteve njerëzore për të trajtuar me efikasitet problematikën.

2.7 Mbrojtja ligjore e viktimave

Në bazë të ligjit 111/2017 “Për ndihmën ligjore të ofruar nga shteti” viktimat e dhunës në familje, si dhe viktimat e dhunës seksuale dhe trafikut njerëzor janë ndër kategoritë që përfitojnë ndihmë juridike ligjore parësore (këshillim ligjor) dhe dytësore (përfaqësim pranë organeve gjyqësore) falas nga shteti dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe ato për ekzekutimin e vendimeve.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, ndihma juridike parësore ofrohet nga 32 ofrues me një shtrirje rreth 90% e territorit, sipas qarqeve: 10 Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, 10 Klinika Ligji pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe 12 Organizata Jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e këtij shërbimi nga Ministria e Drejtësisë. Gjatë periudhës së pandemisë, personat që e kanë pasur të pamundur të paraqiten fizikisht, kanë parashtruar problemet e tyre në platformën *juristionline.al* dhe numrin e gjelbër pa pagesë 08001010, të vëna në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë. Ndhma juridike dytësore ofrohet nga 124 avokatë që veprojnë në 12 qarqe te vendit.

Në bazë të të dhënave, në vitin 2020, nga **4100 raste në total** që kanë përfituar ndihmë juridike parësore, **157 janë viktimat të dhunës në familje**, ndërsa për vitin 2021, nga **5354 raste të trajtuara në total**, rezulton se kanë përfituar ndihmë **juridike parësore 259 viktimat të dhunës** në familje dhe ndihmë juridike dytësore **dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 65 viktimat të dhunës në familje**. Mungojnë të dhënat për përfituesit e ndihmës juridike dytësore për vitin 2020.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet për krijimin e një sistemi të konsoliduar të ofrimit të ndihmës juridike falas në Shqipëri, si një nga aspektet kryesore të garantimit të aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël. Në veçanti, autorizimi i organizatave të shoqërisë civile dhe klinikave të ligjit pranë institucioneve të arsimit të lartë për të ofruar ndihmë juridike, është një risi për të koordinuar më mirë këtë veprimtari dhe për të rritur cilësinë e përfaqësimit ligjor falas në përgjithësi. Megjithatë, Avokati i Popullit konstaton:

- Një vonesë të gjatë për zbatimin e legjislacionit për ndihmën juridike të ofruar nga shteti nga viti 2017, kur u miratua ligji i ri “Për ndihmën juridike falas të ofruar nga shteti” deri në vitin 2019-2020, kur u plotësua kuadri nënligjor i nevojshëm. Kjo ka sjellë një mungesë të ofrimit të këtij shërbimi për viktimat e dhunës në familje dhe mbulimin e tij kryesisht vetëm nga organizatat e shoqërisë civile.
- Numri i rasteve të dhunës në familje që kanë përfituar ndihmë juridike nëpërmjet fondeve publike (Drejtorisë së Ndhmës Juridike) është i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të të gjithë rasteve që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga këto fonde. Kjo është një çështje që kërkon analizë më të thelluar të shkaqeve, por që është një tregues i faktit që viktimat e dhunës në familje nuk marrin kujdesin dhe shërbimin e nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e tyre ligjore, në veçanti gjatë procesit të lëshimit të urdhrave të mbrojtjes. Kjo mund të jetë edhe një nga shkaqet (por që kërkon hulumtim të mëtejshëm), të numrit të vogël të vendimeve gjyqësore për UMM/UM në krahasim me numrin shumë më të lartë të raportimeve në organet e policisë dhe kërkesë paditë të realizuara për UMM/UM. Marrja e një vendimi për masa mbrojtëse kërkon argumentim ligjor dhe paraqitje të provave të nevojshme nga të dëmtuarit dhe shpesh viktimat e dhunës në familje, shumica e të cilave janë gra, nuk kanë akses në të ardhurat e familjeve dhe varen financiarisht nga dhunuesi, duke mos pasur mundësi të sigurojnë përfaqësim ligjor. Për këtë arsye, në ligjin për ndihmë ligjore, kjo kategori ka një status të veçantë trajtimi, që nuk kërkon provimin e të ardhurave financiare për përfitimin e ndihmës ligjore falas, duke e bërë procedurën më të thjeshtuar.
- Të dhënat financiare të Ministrisë së Drejtësisë në këtë drejtim nuk janë shumë të qarta, por duket se kanë të bëjnë me rastet e trajtimit me ndihmë juridike falas nga Drejtoria e Ndhmës Juridike

dhe nuk reflektojnë rastet e përfaqësuara nga organizatat dhe klinkat e ligjit të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë. Mbledhja e këtyre të dhënave, që duhet të realizohet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, do të krijonte një panoramë më të qartë të situatës dhe koordinim më të mirë të punës të të gjithë shërbimeve ligjore falas në vend, për të identifikuar sa më mirë prioritetet e kategorive të përfituesve që kanë më shumë nevojë për këtë shërbim.

- Ndhma juridike dytësore rezultojnë të jetë në nivel shumë të ulët dhe ka nevojë të kemi ndryshime në buxhet ose rialokim të fondeve për të bërë të mundur rritjen e saj në mënyrë eksponenciale.

2.8 Përgatitja e raporteve mjeko-ligjore dhe psikiatriko ligjorë nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose viktimës dhe trajnimet e ekspertëve për çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë ligjore.

Ministria e Drejtësisë informon se ekspertët mjeko-ligjorë, psikiatër-ligjorë, toksikologo-ligjorë dhe biologo-ligjorë përpilojnë akte ekspertimi në bazë të vendimit të dërguar pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, me vendim të organit procedues ose gjykatës, duke marrë edhe mendimin e palëve dhe të pjesëmarrësve në gjykim. Gjatë vitit 2020 janë trajtuar 93 raste mjeko-ligjore dhe në periudhën Janar-Shtator 2021, 53 raste. Po ashtu, ky institucion informon se ekspertët mjeko-ligjorë janë trajnuar që në momentin që bëjnë specializimin për mjekësi-ligjore për dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve dhe aktualisht janë 11 ekspertë mjeko-ligjorë.

Konstatime: Avokati i Popullit vëren se:

- Numri i raporteve mjeko-ligjore gjatë viteve 2020-2021 (nëse u referohen procedimeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje) është shumë më i vogël se numri aktual i procedimeve gjyqësore për masa mbrojtje dhe veprës penale të dhunës në familje. Po ashtu, edhe numri i mjekëve ligjorë në shkallë vendi është shumë i vogël për të mbuluar gjithë kërkesat që mund të ketë për krime të ndryshme, përfshi edhe ato në marrëdhëniet familjare.
- Trajnimet për stafin mjeko-ligjor duhet të jenë të vazhdueshme dhe nuk duhet të mjaftohen vetëm me trajnimin fillestar, pasi legjislacioni, praktikat dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë evoluojnë vazhdimisht dhe kanë pësuar shumë ndryshime vitet e fundit.
- Për viktimat e dhunës në familje nuk është parashikuar e drejta për tu paraqitur dhe egzaminuar drejtpërdrejtë pranë institucionit të mjekësisë ligjore pa patur një vendim nga organi procedues ose institucioni i Avokatit të Popullit. Nevojitet krijimi i mundësive që viktimat e dhunës në familje të paraqiten për egzaminime mjeko-ligjore pa pasur nevojën për vendim nga prokurori apo OPGJ apo AP.

2.9 Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Shkollës së Magjistraturës, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vënien në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse, të listës së përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;

Ministria e Drejtësisë informon se tematikat e dhunës në familje luajnë një rol shumë të rëndësishëm në programet e trajnimit të Shkollës së Magjistraturës si në Programin e Formimit Fillestar, ashtu edhe në atë të vazhdueshëm. Në programin e Shkollës së Magjistraturës, çështjet e dhunës në familje janë trajtuar

në lëndën e të drejtës familjare gjatë periudhës Janar 2020-Shator 2021 e janë ndjekur nga 133 kandidatë për punonjës në organet e sistemit të drejtësisë. Po ashtu, një sërë trajnimesh janë organizuar me gjyqtarë, prokurorë, oficerë të Policisë Gjyqësore, mbi standartet e reja kombëtare dhe ndërkombëtare si kundër dhunës në familje ashtu edhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, përfshi dhunën seksuale. Këto trajnime janë organizuar kryesisht me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të punonjëseve të sistemit të drejtësisë por vëren dhe sugjeron:

- Shtrirjen e këtyre trajnimeve edhe me iniciativën e vetë institucioneve të drejtësisë për të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë në shkallë vendi.
- Një detyrim i rëndësishëm për të cilin nuk raportohet nga Ministria e Drejtësisë është bashkëpunimi ndërmjet këtij insitucioni dhe organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si një detyrim i ndryshimeve të vitit 2018 të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” për organizimin e programeve të trajnimeve në këtë fushë.
- Në veçanti, sugjerohet një angazhim më i madh i organeve qeverisëse dhe monitoruese të sistemit të drejtësisë për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së vendimeve që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse dhe procedimet penale për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore.

2.10 Bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata, që siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve si dhe informacion nëse janë hartuar formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikimin e këtyre të dhënave në vjetarin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë; (Neni 7, paragrafi 3, pikat ç dhe d)

Ministria e Drejtësisë na informon se ky institucion dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor hartuan dhe miratuan Udhëzimin e përbashkët Nr.9, datë 07.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”.¹⁶ Në paragrafin 10 të këtij Udhëzimi përcaktohet se “Deri në krijimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, grumbullimi dhe plotësimi i të dhënave për dhunën në familje do të plotësohen në format exel, sipas formularëve bashkëlidhur këtij udhëzimi”. Ministria e Drejtësisë informon se puna për mbledhjen e të dhënave statistikore po vijon dhe në vjetarin statistikor të vitit 2019 u përfshi për herë të parë një kapitull i detajuar mbi dhunën në familje me informacion nga të gjitha gjykatat e vendit. Ndërkohë, është në proces hartimi i të dhënave statistikore për vitin 2020, i cili pritet të miratohet nga Ministri i Drejtësisë dhe të publikohet në faqen zyrtare të këtij institucioni.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave statistikore dhe në veçanti të dhënat e disagreguara përsa i përket vendbanimit, moshës, gjinisë, statusit civil, numrit të fëmijëve, nivelin arsimor, statusin e punësimit, kërkesat për urdhër mbrojtëse, lidhjet familjare me të dhunuarin, etj. Ky informacion është

¹⁶ Shkresa e MD me nr. Prot 4769/1, date 12/10/2021

shumë i dobishëm për të gjithë aktorët publikë dhe jo publikë që hartojnë dhe zbatojnë programe për luftën ndaj dhunës në familje. Avokati i Popullit i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë publikimin brenda një kohe sa më të shpejtë të të dhënave statistikore për vitin 2021.

SEKSIONI 3: PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI I SHËRBIMEVE PËR TË MBIJEUARAT NË NIVEL QENDROR.

Ky seksion trajton çështjet që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin dhe koordinimin e politikave dhe masave për luftën ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në nivel qendror, duke analizuar rolin e pushtetit qendror përsa i përket menaxhimit të rasteve dhe ofrimit të shërbimeve (në përputhje me detyrimet përkatëse ligjore të legjislacionit kundër dhunës në familje). Në këtë pjesë trajtohet edhe ofrimi i shërbimeve nga strehëzat aftagjata (Strehëza Kombëtare) dhe ato të emergjencës, si dhe qendrave të specializuara (Lilium).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në bazë të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar), është autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. MSHMS luan një rol të rëndësishëm, si institucioni kryesor për hartimin, ndjekjen e zbatimit dhe koordinimit të politikave dhe masave për luftën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Ky institucion, ka inicuar procedurat për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të cituara në Seksionin 1, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në veçanti, MSHMS ka meritën për një përgjigje të shpejtë në drejtim të hartimit të kuadrit ligjor për t’iu përgjigjur situatës së krijuar gjatë pandemisë së COVID-19 në muajt e parë të vitit 2020, ku pati një rritje të konsiderueshme të rasteve të raportuara të dhunës në familje.¹⁷ Më poshtë, po paraqesim shkurtimisht disa nga masat e ndërmrja nga ky institucion gjatë periudhës 2020-2021, në përputhje me detyrimet përkatëse ligjore dhe nënligjore në këtë fushë:

3.1 Buxheti për adresimin e dhunës në familje përsa i përket financimit ose bashkëfinancimit të projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes si edhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. (neni 6, paragrafi c i ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006, për dhunën në familje, i ndryshuar)

MSHMS informon se Fondi Social është një burim i rëndësishëm i mbështetjes financiare përsa i përket financimit apo bashkëfinancimit të shërbimeve dhe projekteve në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Thirrja e parë për aplikim në kuadër të Fondit Social u shpall në prill 2019 dhe fituesit u përzgjedhën në nëntor 2019 (4 bashki fituan projekte në vlerën **69,117,366 lekë (ose rreth 690 mijë euro)** nga buxheti i ministrisë për financimin e shërbimeve sociale për 12 muaj). Një nga këto projekte që filloi të zbatohet në vitin 2020 synonte përdorimin e Fondit Social për ofrimin e shërbimeve

¹⁷ Gjatë periudhës së izolimit (Mars-Maj 2020), numri i thirrjeve/telefonatave në Linjën Kombëtare të Këshillimit ishte trefish më i lartë se në të njëjtën periudhë të vitit 2019, por numri i raportimeve në polici ishte më vogël se në 2019.

emergjente kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në 4 bashki (Gjirokastrë, Berat, Kukës, Maliq). Ndërsa për vitin 2021 vlera e financuar nga Fondi Social për shërbimet për viktimat e dhunës në familje dhe në situatë rreziku, në katër bashki është 11,258,165 Lekë (ose rreth 94 mijë euro).

Në lidhje me mbështetjen e grave të dhunuara të cilat kanë një urdhër mbrojtjeje, janë trajtuar me një pagesë 3000 lekë në muaj 603 gra në vitin 2020. Kurse viktimat të trafikimit të trajtuara me pagesën 3000 lekë në muaj janë 10 raste për vitin 2020. Ndërsa për vitin 2021, në bazë të VKM Nr. 85/2021, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga pandemia Covid-19 për grupet vulnerabël duke përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës në familje të pajisura me UM, përfitojnë dyfishim të ndihmës ekonomike për një periudhë 6 mujore, duke filluar efektet financiare që prej 1 janarit 2021. Megjithatë, MSHMS nuk paraqiti të dhëna se sa gra viktimat të dhunës në familje kishin përfituar nga kjo politikë sociale.

Gjithashtu, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (116 117) është financuar nga MSHMS në vitin 2020 në vlerën 3,901,500 Lekë; ndërsa për vitin 2021 është miratuar dhe financuar për paga dhe sigurime shoqërore për 8 punonjëse në masën 6,768,552 Lekë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon gjithashtu edhe dy shërbime mbështetëse të specializuara në nivel kombëtar, të cilat ofrojnë strehim dhe trajtim afatgjatë me fokus riintegrimin, për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore. Të dhënat mbi buxhetin e planifikuar dhe alokuar për këto dy qendra janë: Qendra Kombëtare për Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare - alokuar 22,735,294 Lekë në 2020 dhe planifikuar 21,530,000 Lekë për vitin 2021). Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit – alokuar 20,854,580 Lekë në 2020 dhe planifikuar 22,350,000 lekë për vitin 2021).

Së fundmi, ky institucion ka financuar gjithashtu edhe tre organizata që ofrojnë shërbime të specializuara strehimi në nivel qarku (“Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, Tiranë; Organizata “Tjetër Vizion”, Elbasan dhe Qendra “Vatra”, Vlorë) në vlerën totale 28,320,466 Lekë për vitin 2020 dhe 28,879,324 për vitin 2021).

Në buxhetin e vitit 2022 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka parashikuar trefishimin e ndihmës ekonomike për gratë e dhunuara, një politikë sociale që do të jetë në ndihmë të këtij grupi shoqëror. Ndërkohë që ka nevojë të ndryshohet ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të mundësuar aksesin paralel të përfitimit të ndihmës ekonomike nga gratë viktimat të dhunës në familje.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet për rritjen e financimeve të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore si shumë të rëndësishme për përmbushjen e detyrimeve ligjore. Por, institucioni ynë vëren se këto fonde, ndonëse një fillim i mirë, janë thelbësisht të pamjaftueshme për të përmbushur të gjithë nevojat si në nivel qendror, ashtu edhe vendor.

Konkretisht:

- Finacimi i projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social vetëm në 4 bashki nuk është i mjaftueshëm, pasi kjo është një nevojë e domosdoshme në shumë bashki të tjera të

vendit, sikurse është bërë e qartë nga to në përgjigjet që i janë kthyer Avokatit të Popullit për këtë raport. Aktualisht në Shqipëri ekzistojnë 12 qendra emergjence në nivel lokal (të financuara nga fondet qëndrore, të bashkive ose donatorëve) dhe është e nevojshme krijimi edhe i 49 qendrave të tjera (Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030). Po ashtu, në Raportin e Vlerësimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2016-2020), të përgatitur po nga MSHMS për shërbimet e specializuara, ku përfshihen qendrat e emergjencës theksohet se “..duhet të merret parasysh fakti që një pjesë e këtyre shërbimeve janë të varura nga donatorët dhe ndërkohë kanë kufizime në burime njerëzore e financiare, infrastrukturë, aplikim në mënyrën e duhur të standardeve ndërkombëtare, etj.”¹⁸

- MSHMS nuk paraqet informacion nëse është monitoruar zbatimi i këtyre projekteve dhe përdorimi i fondeve përkatëse. Nga katër bashkitë që kanë përfituar këto fonde, Bashkia Berat raporton se qendra është krijuar dhe funksionon që nga Shtatori i vitit 2021, Bashkia Gjirokastrë në Janar 2020 dhe bashkia Maliq prej dy vjetësh, por nuk japin informacion mbi numrin e grave ose fëmijëve që kanë përfituar nga shërbimet e tyre. Bashkia Krujë raporton që ka fituar fondin, i cili parashikohet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative, por nuk jep asnjë informacion tjetër nëse qendra është krijuar dhe funksionon.
- Të dhënat mbi shpenzimet e MSHMS për shërbime të ndryshme ndaj viktimave të dhunës në familje kanë nevojë të jenë më të qarta dhe të plotësuara me informacion shtesë sqaruese. Psh. në informacionin e dërguar për këtë raport, theksohet se gjatë vitit 2020 kanë përfituar ndihmë ekonomike 3000 lekë në muaj 603 gra për të cilat është lëshuar një Urdhër Mbrotjtje. Ndërkohë, po për këtë vit raportohet se në shkallë vendi, janë trajtuar me kërkesë padi “*Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrotjtjes/Urdhrit të Mbrotjtjes*” 2816 raste të dhunës në familje, pa u dhënë informacion i mëtejshëm se në sa nga këto gjykime është lëshuar UM dhe sa është numri total i grave që duhet të përfitonin këtë ndihmë ekonomike. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë informon se për vitin 2020 rezultojnë 339 çështje me objekt “urdhër mbrotjtje” të regjistruara për ekzekutim.
- Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e qeverisë për financimin e ofuesve të shërbimeve jo publike, pasi këto organizata janë të specializuara dhe kanë kapacitetet e nevojshme teknike për të ofuar shërbime sipas standardeve të kërkuara. Por edhe në këtë fushë është i nevojshëm shtimi i fondeve si dhe përcaktimi i procedurave të qarta, transparente dhe kompetitive për nën-kontraktimin e organizatave jo qeveritare nga organet e pushtetit qendror dhe vendor për ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në familje (dhe potencialisht ndaj viktimave të formave të tjera të dhunës). Në bazë të legjislacionit në fuqi, qeveria në nivel vendor dhe qendror ka detyrimin të ofrojë një sërë shërbimesh ndaj viktimave të dhunës në familje, përfshirë stehim në strehëza emergjence dhe afatgjata, mbështetje ligjore, piskosociale, shërbime rehabilituese, trajnim profesional, etj. Por, kryesisht për shkak të buxhetimit të pamjaftueshëm nga njësitë e qeverisjes vendore, një pjesë e konsiderueshme e këtyre shërbimeve ofrohen nga

¹⁸ Raport vlerësimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2016 – 2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe UN Women Tiranë, dhjetor 2020

organizata të specializuara, të cilat financohen nga donatorë dhe organizata ndërkombëtare. Por, edhe kur institucionet qendrore ose vendore kanë burime financiare, ofrimi i këtyre shërbimeve është i kufizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve ose specializimit të nevojshëm që kërkohet për të trajtuar viktimat e dhunës. Për këtë arsye, nën-kontraktimi i organizatave të specializuara nëpërmjet procedurave transparente të prokurimit do të ndikonte ndjeshëm në përmirësimin e këtyre shërbimeve. (kjo është një praktikë e njohur në shumë vende të zhvilluara). Aktualisht, mungon një kuadër i qartë nënligjor mbi procedurat e nevojshme të prokurimit në këtë fushë.

- Avokati i Popullit evidenton problematikën që ekziston lidhur me mundësimin e aksesit paralel të përfitimit të ndihmës ekonomike nga gratë viktimat të dhunës në familje.

3.2 Masat për mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e "përshtatjes së arsyeshme", që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi. (neni 6, paragrafi d i ligjit Nr. 9669, date 18.12.2006, për dhunën në familje, i ndryshuar).

MSHMS informon se në nivelin vendor, bazuar në Ligjin 9669/2016 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, ngrihen Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (MKR)¹⁹ të udhëhequra nga bashkitë (autoritetet përgjegjëse për ngritjen dhe fuqizimin e këtyre mekanizmave) dhe të bazuara në filozofinë e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar.²⁰ Sipas këtij institucioni dhe i konfirmuar nga bashkitë që i janë përgjigjur Avokatit të Popullit, **MKR tashmë janë ngritur në të gjitha bashkitë në vend (61 bashki)**. Ndërkohë po vijon puna për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre në mënyrën e trajtimit të rasteve si dhe për kryerjen e të gjitha funksioneve (pra jo vetëm atë të menaxhimit të rasteve në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, por edhe funksione të lidhura me koordinimin, parandalimin dhe informimin, trajnimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve, mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave, si dhe dokumentimin). Për përmirësimin e efektivitetit të ndërhyrjes dhe funksionimit në tërësi të MKR-ve, siç u sqarua edhe në informacionin e përgjithshëm të mësipërm, në qershor 2021 u miratua dhe VKM 327, datë 02.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin

¹⁹ Me VKM 327/2021 përbërja e MKR-së është rikonsideruar dhe si antarë të përhershëm cilësohen: Policia e Shtetit, Drejtoria Vendore e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, struktura për shërbimet sociale pranë bashkisë; Shërbimi Social Shtetëror, Prefekti, Qarku, Zyra Vendore e Punësimit, OJF-të, Strehëzat, Institucionet Fetare me fokus mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, Dhoma e Avokatisë, Drejtoria Ndihmës Juridike Falas. Kurse aktorë të tjerë të rëndësishëm për menaxhimin e rasteve si gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria e rrethit, zyra e përmbarrimit, Qendra e Menaxhimit të Dhunës Seksuale, Shërbimi i Provës, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësit Social, kryetari i fshatit, mjekësia ligjore, mediat lokale dhe profesionistë të tjerë konsiderohen për t'u ftuar herë pas here në mbledhjet e Komiteteve Drejtuese të MKR-ve.

²⁰ Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, b) ekipet teknike ndërdisiplinore dhe c) koordinatoret vendorë. MKR kanë në përbërje të tyre të gjitha institucionet përgjegjëse vendore për zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përfshirë dhe organizata të shoqërisë civile të specializuara për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për menaxhimin e rasteve dhe ndërhyrjen në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimit në tërësi të shoqërisë (organizata që ofrojnë shërbime strehimi, këshillimi psiko-emocional apo ligjor, shërbime rehabilituese dhe riintegruese, informim, aktivitete të fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve e profesionistëve, etj.).

e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”.

Për të përmirësuar efektivitetin e funksionimit të MKR-ve në mbarë vendin, për periudhën 2020-2021 MSHMS, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe shoqërisë civile ka ndërmarrë shumë aktivitete në drejtim të informimit dhe përgatitjes së koordinatorëve vendorë kundër dhunës në familje me përgjegjësitë e tyre, mbështetjen me mentorim dhe informacion të rreth 246 antarëve të 18 MKR-ve në vend gjatë periudhës së kufizimeve për shkak të pandemisë; krijimi i një rrjeti virtual të koordinatorëve vendorë kundër dhunës në familje, ngritja e kapaciteteve të 40 prej tyre²¹ për përdorimin e sistemit REVALB; Ngritja e kapaciteteve të 15-20 anëtarëve të 9 MKR²² për mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje, bazuar në formularin e REVALB; ngritja e kapaciteteve të administratorëve shoqërorë të secilës NJA të 7 MKR-ve²³ për kontributin në mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje në zonat rurale, bazuar në formularin e REVALB; asistencë teknike në 21 MKR²⁴ për përgatitje të raporteve të monitorimit të ekzekutimit të UM dhe reflektimit të tyre brenda afateve kohore në REVALB; asistencë teknike për koordinatorët/koordinatorët vendorë të 27 MKR-ve²⁵, për përgatitje të raporteve të mbledhjeve të ETN/KD si dhe dokumenteve shoqëruese në sistemin REVALB, etj (një informacion i detajuar për të gjitha këto aktivitetet, gjendet në përgjigjen e MSHMS që i bashkëngjitet si aneks këtij raporti). Këto dhe aktivitete të tjera janë organizuar kryesisht me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, të financuara në një masë të konsiderueshme nga Qeveria Suedeze.²⁶

Konstatime: Avokati i Popullit e vlerëson si një arritje shumë të rëndësishme ngritjen e MKR-ve në të gjitha bashkitë e vendit dhe gjithë përpjekjet e institucioneve shqiptare, organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe shoqërisë civile për rritjen e kapaciteteve të tyre. Por, ky institucion gjithashtu vëren:

- Ngritja e MKR-ve në të gjithë vendin është një proces i vonuar, pasi kuadri ligjor në këtë drejtim është miratuar që në vitin 2011 (VKM 334/2011 “Për ngritjen dhe funksionimin e MKR”, i cili u shfuqizua nga VKM 327/2021). Si rrjedhim, MSHMS duhet të përshpetojë masat mbështetëse për të siguruar një funksionim sa më efektiv të të gjithë mekanizmave, ne veçanti atyre të krijuara rishtazi për të mundësuar që krijimi i tyre të mos jetë thjesht një formalitet, por një mekanizëm real që trajton rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare në të gjithë zonat e vendit, përfshi ato rurale.
- Krijimi i këtyre mekanizmave duhet të shoqërohet me fonde mbështetëse për bashkitë për funksionimin e tyre, ne veçanti të krijimit të një pozicioni të dedikuar të koordinatorit vendor që ka përgjegjësinë kryesore për koordinimin e MKR.

²¹ Të MKR-ve: Maliq, Skrapar, Malësi e Madhe, Kuçovë, Ura – Vajgurore/Dimal, Kavajë, Fushë- Arrëz, Has, Pustec, Poliçan, Kolonjë, Memaliaj, Divjakë, Dropull, Konispol, Libohovë, Klos, Pukë, Mat, Vau i Dejës, Tiranë, Pogradec, Korçë, Shkodër, Vlorë, Fier, Patos, Roskovec, Berat, Përrenjas, Himarë, Selenicë, Bulqizë, Përmet, Gjirokastrë, Durrës, Shijak, Belsh, Lezhë, Rrogozhinë, Kamzë.

²² Himarë, Selenicë, Roskovec, Klos, Konispol, Dropull, Divjakë, Has, Maliq

²³ Selenicë, Roskovec, Klos, Konispol, Dropull, Has, Ura vajgurore/Dimal, Maliq

²⁴ Kuçovë, Ura – Vajgurore/Dimal, Fushë- Arrëz, Has, Divjakë, Dropull, Konispol, Klos, Pukë, Mat, Vau i Dejës, Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Fier, Patos, Roskovec, Himarë, Selenicë, Bulqizë.

²⁵ Maliq, Skrapar, Malësi e Madhe, Kuçovë, Ura – Vajgurore/Dimal, Fushë- Arrëz, Has, Pustec, Poliçan, Memaliaj, Divjakë, Dropull, Konispol, Klos, Pukë, Mat, Vau i Dejës, Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Fier, Patos, Selenicë, Bulqizë, Përmet, Shijak.

²⁶ Kryesisht në kuadër të Programit të Përbashkët ndërmjet Qeverisë së republikës së Shqipërisë dhe Agjencive të OKB-së (UNDP, UN Eomen dhe UNFPA), “Për të Luftuar dhunën ndaj Grave në Shqipërisë”, financuar nga Qeveria Suedeze dhe Programi Suedez i Policimit në Komunitet (SCPA)

- Angazhimi dhe dedikimi i fondeve publike për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve për të siguruar një qëndrueshmëri të funksioneve të tyre, përtej mbështetjes që aktualisht ofrohet nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët. Në të njëjtën kohë, kërkohet fuqizimi dhe mbështetja, edhe financiarisht e organizatave të shoqërisë civile që janë ofrues shërbimesh, të cilat në bashkëpunim me pushtetin vendor do të duhen të vazhdojnë këtë mbështetje në vitet në vijim.
- MSHMS nuk paraqiti informacion mbi masat e ndërmarra për mbështetje financiare dhe teknike për të gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e "përshtatjes së arsyeshme", që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje.

3.3 Organizimi i trajnimeve për:

- parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, stafit mjekësor, dhe OJF-ve të licensuara për ofrimin e shërbimeve sociale (neni 6, paragrafi c i Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare",
- trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve socialë në fushën e dhunës në familje, si dhe përgatitja e një liste të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi. (neni 7, paragrafi 2.1, pika a);

Masat për monitorimin për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor. (neni 7, paragrafi 2.1, pika b)

MSHMS informon se gjatë periudhës 2020-2021 janë zhvilluar disa trajnime në këtë drejtim, përfshirë:

- trajnime të punonjësve/punonjësve socialë, administratoreve/administratorëve shoqërorë në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në Qarkun Korçë dhe Vlorë, të cilat do të vazhdohen dhe gjatë vitit 2022 me Tiranën, Elbasanin dhe Durrësin;
- trajnime të punonjësve dhe punonjësve të shëndetësisë për zbatimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si anëtarë të MKR-ve, bazuar në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe të dhunës ndaj grave, si anëtarë të MKR-ve, miratuar me Urdhër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për zbatimin e PSV-ve në praktikë u përgatit gjithashtu dhe u akreditua nga QKEV edhe manuali i trajnimit, i cili ka filluar të zbatohet që në vitin 2020. 41 profesioniste/profesionistë të shëndetësisë janë trajnuar me modul të akredituar nga QKEV për vitin 2020²⁷ dhe 110 punonjës për vitin 2021²⁸;
- trajnime të punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve të kujdesit shoqëror për zbatimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si anëtarë të MKR-ve, trajnime këto të ngjashme me

²⁷ Në bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Shkodër, gjatë muajve nëntor – dhjetor 2020

²⁸ Në bashkitë Fier, Lezhë, Krujë, Kukës, Elbasan, Gjirokastër dhe Korçë gjatë periudhës Prill – Korrik 2021

punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë, në pazë të PSV përkatëse.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson si shumë të rëndësishme miratimin e PSV-ve dhe në veçanti ato për sektorin e shëndetësisë dhe organizimin e trajnimeve përkatëse me stafin mjekësor. Megjithatë, Avokati i Popullit thekson:

- Shëndetësia mbetet një nga sektorët ku janë shfaqur më tepër problematika në drejtim të rolit të tyre për referim të rasteve të dhunës si dhe hartimit të raporteve mjekësore, të nevojshme për tu përdorur në proceset gjyqësore nga viktimat. Në bazë të ligjit për DHF, qendrat shëndetësore kanë detyrimin për të krijuar stuktura të nevojshme për tu siguruar trajtim shëndetësor vikimave të dhunës në familje. Po ashtu, viktimat kanë të drejtë të përfitojnë trajtim mjekësor dhe psikologjik dhe duhet të referohen në qendrat e specializuara të shërbimeve. Rastet e dhunës në familje duhet të regjistrohen dhe ti komunikohen ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë sipas formularëve të përcaktuar për këtë qëllim. Gjithashtu, viktimat kanë të drejtë të marrin një raport mjekësor mbi çdo lloj dëmtimi shëndetësor si pasojë e dhunës. Por, vihet re se zbatimi i këtyre dispozitave është i pamjaftueshëm dhe nuk zbatohet rregullisht nga stafi mjekësor si pasojë e hezitimit të tyre për të raportuar rastet e dhunës, kryesisht për shkak të frikës së ekspozimit të tyre si dhe viktimave ndaj hakmarrjes së dhunuesve.
- Ky ishte një nga konstatimet kryesore edhe në raportin e GREVIO-s në raportin vlerësues ndaj Shqipërisë, i cili i kërkon qeverisë së Shqipërisë të marrë gjithë masat e kërkuara ligjore në këtë drejtim. Po ashtu, edhe vetë MSHMS në përgjigjen që i ka dërguar Avokatit të Popullit për këtë raport, thekson se të dhënat e deritanishme flasin për një rol tepër pasiv të personelit shëndetësor në zbatim të këtij detyrimi ligjor dhe për këtë arsye në trajnimet e zhvilluara deri tani për përdorimin e PSV-ve si dhe në të gjitha trajnimet e përbashkëta me shëndetësinë dhe anëtarët e tjerë të MKR-së, është theksuar gjithnjë e më tepër roli i punonjësve të shëndetësisë në këtë drejtim dhe detyrimi ligjor që duhet të përmbushin.

3.4 Masat në lidhje me bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave (Neni 6, paragrafi d)

MSHMS në vitet e fundit ka bërë përpjekje të vazhdueshme për mbledhjen në mënyrë periodike të të dhënave për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare nga disa institucione kryesore si Policia e Shtetit, institucionet publike që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara, etj. Këto të dhëna sipas rastit kërkohen dhe mblidhen edhe në kuadër të raportimeve të ndryshme periodike të shtetit në lidhje me zbatimin e instrumenteve ndërkombëtarë të ratifikuar. Po kështu, gjatë vitit 2020, në kuadër të vlerësimit të zbatimit të SKBGJ 2016-2020, MSHMS kërkoi dhe mblodhi të dhëna nga të gjitha institucionet përgjegjëse dhe partnere në zbatimin e masave dhe veprimeve të parashikuara nën këtë strategji, të cilat i përpunoi më pas dhe i paraqiti në Raportin e “Vlerësimit të Zbatimit të SKBGJ 2016-2020”. Ky raport u nda dhe me nënkomisionin parlamentar për çështjet e barazisë gjinore dhe të

parandalimit të dhunës ndaj grave, ndërkohë që është i publikuar edhe në faqen e MSHMS²⁹.

MSHMS ka edhe një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave mbi rastet që identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar përmes Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në nivelin vendor, në sistemin REVALB, një sistem i përgatitur posaçërisht për këtë qëllim. Gjatë dy viteve të fundit janë bërë një sërë ndërhyrjesh përmirësuese në sistem dhe paralelisht është punuar edhe me trajnimin e koordinatorëve/koordinatorëve vendorë me qëllim që të mund të vijnë me hedhjen rregullisht e në mënyrë të përditësuar të të dhënave. Sistemi bën të mundur jo vetëm mbledhjen e të dhënave mbi numrin e rasteve të trajtuara, por edhe mbi performancën e institucioneve, urdhërat mbrojtës të lëshuar dhe monitorimin e tyre, etj. Seksioni i monitorimit të urdhërave mbrojtës dhe shkeljeve të tyre është shtuar në sistem. Sistemi gjeneron të dhëna edhe sipas grupeve të disavantazuara si rome, persona me aftësi të kufizuara, sipas grupmoshës, ndarje zonë rurale dhe zonë urbane; sipas punësimit, arsimit etj.

Aktualisht, është duke u punuar për të patur një harmonizim të të dhënave midis REVALB dhe bazave të të dhënave të tjera kombëtare. Një model i tillë është sinkronizimi i të dhënave midis sistemit të zgjeruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe REVALB, për të mundësuar statistika më të plota dhe në kohë reale mbi masat e mbrojtjes kundër dhunës në familje të lëshuara nga gjykatat për Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Të dhëna mbi bazë 3, 6, 9 mujore dhe 1 vjeçare i vihen MSHMS në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit, bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. 1531 datë 24.10.2014 “Për hartimin e statistikave të kriminalitetit”, administron të dhëna për dhunën dhe krime të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, si dhe të dhëna për të dëmtuarit nga vepra penale, të ndara sipas gjinisë.

Të dhënat nga Sistemi REVALB

Të dhënat për vitin 2020: 40 bashki kanë hedhur të dhënat në sistem dhe i kanë përditësuar. Rezultojnë **1003** raste të hedhura në sistem nga të cilat: gra 819 dhe burra 184; të mitur 30 nga të cilët 22 vajza dhe 8 djem; Numri i personave me Aftësi të Kufizuara është 9, nga të cilët 7 gra/vajza dhe 1 burrë. Numri i personave me aftësi të kufizuara për 2020 është 7, nga të cilat 7 gra/vajza dhe 2 burra/djem. Nga minoriteti Rom-Egjiptian ka patur 12 raste, 9 gra/vajza dhe 3 djem/burra. Sipas zonës urbane/rurale 574 raste në zonën urbane dhe 429 raste në zonën rurale.

Të dhënat për periudhën janar-shtator 2021: 38 bashki kanë hedhur të dhënat në sistem dhe i kanë përditësuar. Rezultojnë 943 raste të dhunës në familje nga të cilat 791 gra/vajza dhe 152 burra/djem; 26 të mitur/mitura nga të cilët/cilat 4 djem dhe 22 vajza të mitura; persona me aftësi të kufizuara 7 nga të cilët 6 gra/vajza dhe 1 burrë; nga minoriteti Rom-Egjiptian ka patur 11 raste nga të cilët 8 gra/vajza dhe 3 burra/djem.

Të dhënat nga Drejtoria e Policisë

²⁹ Shiko: <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Raporti-i-vleresimit-te-SKBGJ-2016-2020.pdf>

Gjatë vitit 2020: Janë evidentuar gjithsej **4701** raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare.

Për periudhën 01.01.2021 – 30.06.2021, nga strukturat e policisë janë evidentuar: 2433 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e MSHMS për bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore për rastet e dhunës në familje, krjimin e sistemit REVALB dhe masat për përmirërimin e tij. Megjithatë, ky institucion konstaton:

- Nevojën për shtrirjen e këtij sistemi në të 61 bashkitë e vendit, pasi ky shërbim aktualisht realizohet vetëm në pak më shumë se gjysmën e Bashkive në vend.
- Hedhjen rregullisht të të dhënave nga të gjithë institucionet që kanë detyrimin ligjor, në veçanti të strukturave vendore pasi, sikurse vihet re nga të dhënat, ka një diferencë të konsiderueshme të numrit të rasteve të raportuara nga MKR-të dhe të dhënave të Policisë së Shtetit. Kjo dëshmon për mungesë koordinimi ndërmjet këtyre institucioneve, një çështje e cila është ngritur vazhdimisht nga shumë aktorë publikë dhe organizata të shoqërisë civile të përfshira në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Intensifikimin e masave mbështetëse dhe monitoruese nga MSHMS për mbledhjen dhe koordinimin e sistemit të të dhënave.

3.5 Ofrimi dhe mbikëqyrja e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të viktimave të dhunës në familje.(neni 6, paragrafi gj):

MSHMS informon se Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje është një institucion shtetëror, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Kjo qendër funksionon në bazë të standardeve, procedurave dhe politikave të MSHMS sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore. Qëllimi i qendrës është mbrotja, rehabilitimi dhe integrimi i vajzave, grave dhe fëmijëve, viktimave të dhunës në familje për t'i drejtuar për një jetë të pavarur. Në këtë Qendër akomodohen gra dhe vajza nga 18 vjeç e lart dhe fëmijë vajza/djem 0-18 vjeç. Grupmosha më e madhe në numër që përfiton shërbime pranë kësaj qendre janë gra dhe vajza nga 25- 35 vjeç. Qendra ofron një sërë shërbimesh, përfshirë: shërbime bazë (ushqim, veshje, strehim të përkohshëm), asistencë psiko sociale, asistencë ligjore, asistencë mjekësore, edukim arsimor për fëmijët, kualifikime dhe trajnime profesionale/ punësimi, aktivitete okupacionale, rehabilituese, referim për riintegrim; përgatitje për riintegrim³⁰, ndërmarrja e negociatave për riintegrim³¹, monitorim dhe vlerësim i rasteve pas referimit

³⁰ a) përmes punësimit publik dhe privat; b) ndjekja e kurseve profesionale në bashkëpunim me DRFPP 1 dhe DRFPP4 Tiranë **si dhe** -Rintegrim përmes strehimit social. a) Asistohen gratë në programin e strehimit social të ofruara nga Bashkia Tiranë ose Njësitë Administrative ku ato integrohen për plotësimi e dosjes së aplikimit dhe dorëzimin e saj pranë njësive të sipërpërmendura. b) Ndërmjetësohet me OJF të ndryshme për mundësinë e pagesës së qerasë ose ndihma te tjera për gratë ne procesin e integritimit

³¹ Pjesa më e madhe referuar statistikave dalin për jetesë të pavarur në komunitet; Nje pjesë kthehen pranë familjeve biologjike Rastet pasi dalin nga qendra referohen pranë Njësive Administrative ku integrohen për ndihmë të mëtejshme gjatë procesit të integritimit

pranë qendrave riintegruese apo komunitet.³²

MSHMS informon se kryen monitorimin e qendrës në bazë të planit vjetor të veprimit të drejtorisë së shërbimeve sociale pranë SHSSH-së, çdo vit dhe sa herë qendra has problematika të ndryshme në ushtrimin e aktivitetit të saj social. Ndërkohë, Shërbimi Social Shtetëror po rishikon strukturën e qendrës për të shtuar me kohë të plotë pozicionin e juristit dhe psikologut si profesionistë të rëndësishëm në mbështetje të rasteve të akomoduara në qendër. Këto pozicione janë mbuluar nga OJF të ndryshme që ofrojnë shërbime të tilla dhe në shumë raste nga psikologia në SHSSH.

Gjithashtu, MSHMS ka paraqitur edhe të dhënat mbi përfitueset e qendrës:

- Gjatë vitit 2020 janë trajtuar gjithsej 60 banorë/banore, nga të cilët/cilat 23 gra dhe 37 fëmijë (19 vajza dhe 18 djem). Kanë hyrë në programin e qendrës 47 banorë/banore nga të cilët/cilat 19 gra dhe 28 fëmijë (17 vajza dhe 11 djem). Kanë dalë nga programi 51 banorë/banore nga të cilët/cilat 19 gra dhe 32 fëmijë (17 vajza dhe 15 djem)
- Për periudhën 1 janar 2021- 30 shtator 2021 janë trajtuar gjithsej 67 banorë/banore nga të cilët/cilat 32 gra dhe 35 fëmijë (22 vajza dhe 13 djem). Kanë hyrë në program 59 banorë/banore nga të cilët/cilat 29 janë gra dhe 30 fëmijë (19 vajza dhe 11 djem). Kanë dalë nga programi 58 banorë/banore nga të cilët/cilat 27 gra dhe 31 fëmijë (18 vajza dhe 13 djem)

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mundësinë e ofrimit të një game te gjerë shërbimesh për gratë që strehohen në qendër. Por, Avokati i Popullit gjatë kohës së hartimit të këtij raporti organizoi edhe një vizitë monitoruese të drejtpërdrejtë në qendër dhe konstatoi:

- Numri i përfituesve të qendrës është i vogël, në krahasim me numrin shumë më të madh të rasteve të referuara të dhunës në familje në shkallë vendi. Kjo mund të vijë për disa arsye, duke filluar nga refuzimi i viktimave për tu strehuar në qendër, por edhe largësia e saj, duke qënë se kjo është e vetmja qendër që ofron strehim afatgjatë në të gjithë Shqipërinë. Si rrjedhojë, është e domosdoshme ngritja e qendrave afatgjata në qarqet kryesore të vendit për të qenë të aksesueshme për të gjitha gratë, përfshi ato nga zonat rurale.
- Mungesën e kapacitete të mjaftueshme të profesionistëve si punonjës social, psikologë e jurist, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standarteve të përkujdesit shoqëror.
- Mungesë të njohurive të stafit lidhur me Standardet e Shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.
- Mungesë në pajisjen me veshje për përfitueset dhe fëmijët e tyre.
- Mungesa e një sistemi ngrohjeje qendrore dhe si pasojë jo të gjitha ambientet janë të përshtatshme për shëndetin dhe mirëqenien e përfituesve.
- Zhvillimi aktivitetëve të pakta dhe të pamjaftueshme argëtuese dhe edukative në qendër për rehabilitimin dhe ri-integrimin e përfitueseve të Qendrës dhe të fëmijëve të tyre.
- Mungesa në materialet didaktike, edukative e lodra për fëmijët.
- Mjeti për transportin e përfitueseve nuk i mbulon të gjitha nevojat që përfitueset dhe fëmijët e

³² Për të gjitha banoret që integrohen, u është dërguar shkresë zyrtare për ndjekje, monitorim dhe mbështetje Njësie Administrative ku kanë shkuar si edhe Komisariteve të Policisë, Kontakteve telefonike, Kontakteve të drejtpërdrejta, vizitave në familje , vizita në vendin e punës

tyre kanë për shërbime të ndryshme dhe në çdo orë.

3.6 Masat për ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale dhe monitorimi i tyre (Neni 7, paragrafi 2/1, pika c)

Qendra e parë për menaxhimin e krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM", u ngrit në 04.12.2018, me fonde të buxhetit të shtetit, në zbatim të rekomandimeve të CEDAW dhe Komitetit të Palëve e raportit të vlerësimit fillestar të GREVIO. Në këtë qendër, ofrohet shërbim emergjent, me një ndalesë, 24/7 dhe afatshkurtër (24 - 72 orë), për viktimat/të mbijetuarit/mbijetuarat e dhunës seksuale dhe familjarët e tyre. Ngritja e shërbimit u parapri nga vlerësimi i situatës, prezantimi i modeleve ndërkombëtare³³ dhe vizita studimore në vende të tjera, paralelisht me përgatitjen e standardeve të funksionimit të qendrës³⁴. Në LILIUM ofrohet modeli socio-shëndetësor, me ekip multidisiplinar me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë. Për trajtimin afatgjatë të rasteve rol të veçantë luan bashkëpunimi me Mekanizmat e Koordinuar të Referimit. Ambientet e rikonstruara të qendrës përmbushin standardet e shërbimit. Gjatë pandemisë COVID-19 u përgatit rregullore shtesë për funksionimin e saj.

Qendra Liliu ka trajtuar nga fillimi i funksionimit të saj deri në shtator 2021, **89** viktima të dhunës seksuale, nga të cilët 80 % të rasteve janë fëmijë (kryesisht vajza). Të dhënat për periudhën e kërkuar për përgatitjen e këtij informacioni jepen në tabelën në vijim (gjatë vitit 2020, 25 persona dhe gjatë vitit 2021 (deri në shtator 25).

Monitorimi i Qendrës LILIUM kryhet nëpërmjet raporteve periodike të dërguara nga Qendra pranë Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, dhe sipas kërkesës së këtij Sektori, vizitave në ambientet e qendrës nga përfaqësues të sektorit në MSHMS. Për vitin 2020 ka patur një takim në qendër. Për vitin 2021 ka patur 2 takime. Shihen në vend mirëmbajtja e ambjentëve dhe diskutim me koordinatoren e qendrës për problematikat e qendrës, si dhe paraqitja e raportit 1 vjeçar të monitorimit të Qendrës në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore. Raporti i vitit 2019 është paraqitur në mbledhjen e KKBGJ datë 21 janar 2020.

Konstatime: Avokati i Popullit e vlerëson ngritjen e kësaj qendre, si shumë të nevojshme për të asistuar viktimat e dhunës seksuale. Po ashtu, vlerësohet edhe kuadri nënligjor për funksionimin e qendrës. Ndërkohë, Avokati i Popullit konstaton:

- Nevojën për ngritjen e qendrave të tjera rajonale, të specializuara për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës seksuale, pasi një qender për të gjithë vendin është e pamjaftueshme dhe mund të jetë e vështirë për tu aksesuar nga viktimat e dhunës seksuale që jetojnë larg vendodhjes së saj. Rekomandohet që një nga këto qendra të jenë të disponueshme për çdo 200 000 banorë dhe me shtrirje gjeografike të gjerë për të ti bërë të aksesueshme si për viktimat nga zonat e thella

³³ Vlerësimi i situatës dhe prezantimi i modeleve ndërkombëtare u bë me mbështetjen e UN Eomen

³⁴ Vizita studimore, përgatitja e standardeve si dhe mbështetja për ngritjen e qendrës u dha nga UNDP

rurale ashtu edhe atyre të zonave urbane³⁵. Avokati i Popullit vlerëson planfikimin në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2021-2030) të ngritjes së **4 qendrave rajonale** për shërbime mbështetëse të specializuara për sulmet seksuale dhe trafikimin për qëllime të shfrytëzimit seksual përgjatë periudhës 2022-2030 dhe **dy shërbimeve afatgjata për rikuperimin e traumës për viktimat e dhunës seksuale** dhe trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual, përfshirë dhe viktimat/ të mbijetuarat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht kohës së sulmit të pësuar. Por, institucioni ynë sugjeron pëshpejtimin e masave, përfshi ato financiare për ngritjen brenda një kohe të shpejtë të këtyre qendrave.

- Nevojën për mbështetje të mëtejshme nga qeveria të organizatave jo qeveritare dhe strehëzave që mund të ofrojnë shërbime më afatgjata dhe të specializuara për viktimat, pasi zakonisht, edhe në vendet e tjera këto qendra janë më të specializuara dhe kanë më tepër kapacitete për tu ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme viktimave të dhunës seksuale.
- Përsa i përket zbatimit të standarteve të miratuara të qendrës, nga inspektimi i kryer nga Avokati i Popullit konstatohet se:
 - Standardi i parë i Qendrës që parashikon se “Qendra ofron shërbime përmes një ekipi multidisiplinar që përbëhet nga mjekë gjinekologë, mjekë ligjorë, psikiatër, pediatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës policie, infermierë” nuk zbatohet rregullisht. Ekzaminimi gjinekologjik i rasteve nuk është kryer në ambientet e Qendrës. Në të njëjtën kohë është cënuar parimi i qendrës për “Siguri dhe dinjitet njerëzor”, pasi ndërhyrjet nuk respektojnë mjaftueshëm dinjitetin dhe sigurinë e viktimave.
 - Qendra nuk ka ende një staf të dedikuar, përgjegjës për ofrimin e mbështetjes emergjente dhe vlerësimit psikologjik. Si shkak i mos-kryerjes së ekzaminimit brenda ambienteve të Qendrës, ishte i pamundur ofrimi i mbështetjes dhe vlerësimit psikologjik.
 - Mjekët ligjorë si dhe profesionistët e tjerë të angazhuar në Qendër, hasin shumë vështirësi gjatë kryerjes së ekzaminimeve. Aktualisht Liliu nuk ka pajisje të cilat lehtësojnë ekzaminimin (veçanërisht ekzaminimin mjeko-ligjor) dhe kjo pengon dhe vështirëson në të njëjtën kohë marrëdhënien e stafit të Qendrës me profesionistët e tjerë të sipërpërmendur.
 - Mungesë të veshmbathjeve/veshjeve për viktimat që paraqiten në qendër dhe materialeve higjieno-sanitare të domosdoshme për viktimat, sidomos ato që rrinë më shumë se 24 orë në qendër.
 - Mungesë të referimit direkt nga Policia në qendër të rasteve të dhunës seksuale
 - Mungesë e një koordinimi të shërbimeve të tjera mjekësore që duhet të ofrohen për viktimat në qendër, si psh në rastet e traumave/goditjeve etj, viktimat duhet të referohet jo në QSUT por në Spitalin e Traumës.

3.7 Masat për mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare.

³⁵ Final Activity Report of the Council of Europe Task Force to Combat Violence against Women, including Domestic Violence (EG-TFV (2008)6)

Sipas MSHMS, në Shqipëri shërbimet për rehabilitimin e shkaktarëve të dhunës në marrëdhëniet familjare janë ende të kufizuara, megjithëse ka fillesa pozitive në këtë drejtim. Ky institucion vlerëson bashkëpunimin me të dy qendrat e këshillimit për djemtë dhe burrat në Tiranë dhe Shkodër. Të dhënat nga vlerësimi i zbatimit të SKBGJ 2016-2020 tregojnë se:

- Për periudhën 2016 - 2020, Nga Linja e Këshillimit për Djem dhe Burra është bërë i mundur ofrimi i këshillimit 366 personave të cilët kanë pranuar me dëshirë të marrin pjesë në këtë program. Ndërsa rastet e referuara nga gjykatat (23 raste) e kanë patur detyrim pjesëmarrjen në programin e rehabilitimit për dhunuesit.
- Zyra për Djem dhe Burra në Shkodër, në periudhën 2016-2020 ka ofruar këshillim për 157 burra të cilët kanë ushtruar dhunë në familje dhe 137 djem, të cilët janë referuar nga shërbimi psikologjik shkollor dhe kanë marrë këshillim individual dhe në grup (grupet reflektive të të rinjve agresivë). Vetëm në periudhën Janar - Tetor 2020 është ofruar shërbim për 67 burra dhe djem që kanë ushtruar dhunë dhe kanë shfaqur agresivitet me bazë gjinore.

Për të avancuar më tej në plotësimin e detyrimit ligjor për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për dhunuesit, në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021 – 2030 janë parashikuar një sërë masash në lidhje me bazën nënligjore mbi përmbajtjen dhe formën e programeve rehabilituese dhe shtrirjen e programeve rehabilituese të pilotuara në të 12 qarqet në vend - nën përgjegjësinë e MSHMS për t'u realizuar gjatë periudhës 2026-2030.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e MSHMS për bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, por vëren:

- Pamjaftueshmërinë e programeve ekzistuese për ti ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje një numri shumë më të madh të shkaktarëve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Normalisht, në të gjitha vendimet gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes, të lëshuara pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 125/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” duhet të parashikohet urdhërimi i dhunuesit të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimin prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private. Por, mungesa e këtyre qendrave e bën të pamundur zbatimin efektiv të kësaj dispozite dhe Avokati i Popullit sugjeron përshtetimin e përpjekjeve për ngritjen e këtyre qendrave në të gjitha qarqet e vendit, sa më shpejt, dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ.
- Avokati i Popullit, gjithashtu sugjeron ndryshime ligjore ose nënligjore për të siguruar mënyra alternative për zbatimin e këtij detyrimi, si psh këshillimi në distancë ose online nga qendrat rehabilituese ekzistuese. (kjo çështje është trajtuar edhe në seksionin mbi legjislacionin).
- Nevojën për një bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse, përfshi policinë, gjykatën, shërbimet e provës dhe drejtorinë e burgjeve për identifikimin dhe përfshirjen në programet e rehabilitimit të shkaktarëve të dhunës në familje.
- Nevojën për shtrirjen e këtyre shërbimeve edhe për shkaktarët e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhunës seksuale, ngacmimit, përndjekjes, etj.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (detyrimet e mëposhtme rrjedhin nga Neni 7, paragrafi 3/1 i ligjit për dhunën në familje):

- Hartimi i programeve mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;
- Përgatitjen e teksteve shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- Përgatitja e programeve për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktime, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.

Ministria e Arsimit dhe Sportit informon për një sërë programesh dhe nismash që janë ndërmarrë në sistemin arsimor parauniversitar për parandalimin e dhunës në institucionet arsimore si dhe luftës kundër bullizmit dhe ekstremizmit. Ky institucion, gjithashtu informon se nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për përgatitjen e teksteve shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare nga Agjencia e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Po ashtu, nuk dërgohet asnjë informacion mbi programet mësimore në shkollat e mesme dhe të larta si dhe përgatitjes së programeve për arsimin parauniversitar dhe profesional të të miturve dhe të rinjve dhunues ose viktime, me qëllim rehabilitimin dhe rishoqërimin e tyre.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e MAS për programet mbi parandalimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor shqiptar, si shumë të rëndësishme për parandalimin e dhunës në shoqëri, përfshi edhe dhunën në marrëdhëniet familjare. Por Avokati i Popullit vëren se:

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka bërë përpjekje për zbatimin e detyrimeve të tjera të saj, të përcaktuara qartë në legjislacionin kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Informacioni për këtë lloj dhune për brezin e ri është një nga masat më të rëndësishme parandaluese dhe duhet të trajtohet me seriozitetin e duhur nga institucionet arsimore. Dhënia e informacionit për këtë fenomen për moshat e reja do të ndikonte në rritjen e një brezi më të ndërgjegjësuar dhe do të ndikonte edhe për reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare.

SEKSIONI 4: MENAXHIMI I RASTEVE NGA MEKANIZMAT E REFERIMIT DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE NË NIVEL LOKAL

Ky seksion trajton çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel vendor nga Mekanizmat Kombëtarë të Referimit, bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të mekanizmit dhe sigurimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës më bazë gjinore.

Avokati i Popullit u kërkoi informacion të 61 bashkive në vend dhe vlerëson përgjigjet e dërguara nga shumica e tyre, më përjashtim të 9 bashkive.³⁶

Bashkive iu kërkua të dërgonin informacion mbi detyrimet kryesore të tyre, në bazë të Ligjit Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar dhe VKMs nr. 327, datë 2.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur përgjigjet e bashkive për këto çështje dhe informacione plotësuese të siguruara nga burime të tjera³⁷ si dhe konstatimet përkatëse të Avokatit të Popullit.

4.1. Informacion mbi angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR-ve) dhe hartimit nga Kordinatori Vendor dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psiko-sociale të viktimës.

Të gjitha bashkitë që kthyen përgjigje informuan se kanë ngritur MKR-të³⁸, me nismën e tyre, ose me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile. Një numër i konsiderueshëm MKR janë krijuar gjatë vitit 2020 dhe 2021, ndërsa një pjesë e mekanizmave të krijuara vitet e mëparshme, por jo regullisht funksionale, janë riaktivizuar. Gjithashtu, në shumë prej bashkive është krijuar pozicioni i Koordinatorit Vendor të Dhunës në Familje (KVDHF), ose një punonjës i Barazisë Gjinore. Meghithatë, jo të gjitha bashkitë që kanë raportuar specifikojnë nëse ky pozicion është i dedikuar vetëm për koordinimin e dhunës në familje, apo KVDHF kryejnë edhe funksione të tjera. Sipas MSHMS, deri në fund të vitit 2020, 58 nga 61 bashki kanë përcjellë pranë MSHMS të dhënat mbi personin me kohë të plotë të caktuar për të mbuluar detyrat e Nën-punësit të Barazisë Gjinore, por edhe të KVDHF apo të Specialistes/Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijëve. Tre bashki kanë tentuar t'i ndajnë këto pozicione, megjithatë momentalisht, në kushtet në të cilat ndodhet vendi dhe nisur edhe nga problematikat përsa u takon fondeve të NJVV, shihet si e pamundur ndarja e mëtejshme e këtyre pozicioneve.

Përsa i përket mbledhjeve të rregullta të Komiteteve Drejtuese dhe Ekipeve Teknike Ndërdisciplinore (ETN), shumica e bashkive përgjigjen në mënyrë të përgjithshme se këto takime organizohen rregullisht, por pak Bashki japin informacion të detajuar mbi numrin e takimeve gjatë viteve për të cilat u është kërkuar

³⁶ Fier, Finiq, Konispol, Malesi e Madhe, Prrenjas, Puke, Permet, Roskovec, Rogozhine

³⁷ Raporti I monitorimit të Strategjisë së barazisë Gjinore 2016-2020, përgatitur nga MSHMB dhe raporte monitorimi të përgatitura nga shoqëria civile.

³⁸ Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, b) ekipet teknike ndërdisciplinore dhe c) koordinatorët vendorë. MKR kanë në përbërje të tyre të gjitha institucionet përgjegjëse vendore për zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përfshirë dhe organizata të shoqërisë civile të specializuara për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të domosdoshme për menaxhimin e rasteve dhe ndërhyrjen në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimit në tërësi të shoqërisë (organizata që ofrojnë shërbime strehimi, këshillimi psiko-emocional apo ligjor, shërbime rehabilituese dhe riintegruese, informim, aktivitete të fuqizimit të kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, etj.).

informacion (Bashkitë Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Lushnjë, Durrës, etj). Në përgjithësi bashkitë ku organizohen takime të rregullta të anëtarëve të MKR-ve janë bashki të mëdha dhe në të cilat MKR është krijuar prej disa vitesh.

Nga një monitorim i kryer nga organizata të shoqërisë civile në rreth 14 bashki të vendit³⁹, për përmbushjen e detyrimeve të tyre, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2016-2020), rezulton se numri i takimeve të ENT ka qënë më i shpeshtë gjatë vitit 2020, se sa ai Komiteteve Drejtuese, ku në disa raste gjatë vitit 2020 nuk është realizuar asnjë mbledhje. Por, edhe mbledhjet e ENT gjatë vitit 2020 (periudha e pandemisë) në disa prej bashkive kanë qënë më të pakta se vitet paraardhëse.⁴⁰

Përsa i përket rolit të MKR dhe KVDHF për menaxhimin e rasteve të dhunës, hartimit të planeve individuale të ndërhyrjes dhe ofrimit të shërbimeve të menjëhershme, përgjigjet që Bashkitë i kanë dërguar Avokatit të Popullit ndahen në dy grupe kryesore: (i) Bashkitë që përmendin në përgjithësi hartimin e planeve individuale dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme të menjëhershme, por pa dhënë informacion specifik mbi numrin e viktimave për të cilat është hartuar ky plan, apo shërbimet specifike që kanë përfituar dhe (ii) bashki që kanë dhënë informacion më të detajuar për numrin e subjekteve dhe shërbimeve specifike që kanë përfituar. Ndër bashkitë e grupit të dytë përmendim Tiranën, Shkodrën, Elbasanin, Vlorën, Durrësin, Korçën, Beratin, Devoll, Dimal, Gjirokastrë, Kamëz, Kuçovë, Lushnjë, Mallakastër, Pogradec, Sarandën etj.

Përsa i përket shërbimeve të ofruara në bashkitë e grupit të dytë, në disa prej tyre funksionojnë qendra emergjence 48 ose 72 orëshe (Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Elbasan, Kamëz, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Lushnjë, Maliq, Pogradec, Sarandë, Tiranë, Vlorë), ku gratë dhe fëmijët e tyre mund të gjejnë strehim për të siguruar mbrojtje të menjëhershme, deri në marrjen e masave afatgjata dhe nxjerrjen e urdhërave të mbrojtjes. Por, shumica e këtyre qendrave ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile me mbështetjen e donatorëve. Ndërkohë, ka edhe Bashki që kanë krijuar qendrat e tyre si Korça, Kruja, Dibra, Saranda, Gjirokastra. Megjithatë, në përgjithësi, bashkitë ku janë krijuar këto qendra, në veçanti ato të krijuara me fonde publike, nuk japin informacion mbi numrin e përfitueseve.

Përsa i përket shërbimeve të tjera, bashkitë informojnë që shumica e shërbimeve të emergjences përfshijnë ndihmë ligjore, këshillim psikosocial, paketa ushqimesh dhe higjienosantare, dhe më tej shërbimet më afatgjata përfshijnë ndihmë ekonomike (për viktimat që përfitojnë UM), bonuse qiraje, ose strehim social, pagesë për çerdhe dhe kopshte fëmijësh, etj. Në disa bashki operojnë gjithashtu edhe linja telefonike këshillimi lokale. Megjithatë, ka shumë pak të dhëna mbi numrin e viktimave që kanë përfituar nga të gjitha këto shërbime, shpenzimet përkatëse të bashkive, apo të dhëna mbi shumat e harxhuara nga buxhetet e bashkive për këtë çështje, etj.

Në përgjithësi, bashkitë kanë të parashikuara në buxhetet e tyre vetëm pagat për koordinatorët e dhunës me bazë gjinore, ndërsa shpenzimet e tjera parashikohen në fondin e shpenzimeve sociale, (përveç

³⁹ Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë, Pukë, Berat, Kurbin, Kamëz, Lezhë, Sarandë, Fier dhe Pogradec

⁴⁰ Monitorimi i Qëllimit të III të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të Veprimit (2016-2020), GADC, me mbështetjen e UN Women, Qeverisë Suedeze dhe Bashkimit Evropian, 2021

https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Buletini%20Informativ_Monitorimi%20MKR_5%20bashki.pdf
https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Buletini%20Informativ_Monitorimi%20MKR_9%20bashki.pdf

ndihmës ekonomike për këtë kategori që parashikohet në buxhetin e përgjithshëm) të pidentifikuara me zë të veçantë, gjë që e vështirëson si planifikimin ashtu edhe identifikimin e tyre.

Disa bashki gjithashtu informojnë mbi aktivitete trajnuese për anëtarët e MKR-ve dhe organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere në komunitet, por në përgjithësi me mbështetjen e organizatave.

Një element tjetër që duhet theksuar është që bashkitë nuk informuan për mënyrën sesi e kanë menaxhuar ofrimin e shërbimeve gjatë periudhës së pandemisë së Covid-19, në veçanti gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, ku pati kufizime të lëvizjes dhe rritje të rasteve të dhunës në të gjithë vendin. Ndërkohë, nga informacionet që ka marrë Avokati i Popullit, përfshirë nga raportet e organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile shqiptare ka pasur një mungesë shërbimesh gjatë kësaj periudhe (Shkurt-Prill 2020) dhe mungesë koordinimi për menaxhimin e rasteve, gjë që solli nevojën për hartimin e një sërë aktesh nënligjore për çështjet e dhunës me bazë gjinore gjatë pandemisë.⁴¹

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson masat e marra dy vitet e fundit për krijimin e MKR-ve në të gjitha bashkitë e vendit si një nevojë e domosdoshme, por dhe detyrim që duhej të ishte përmbushur vite më parë. Po ashtu, vlerësohen përpjekjet për zgjerimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme si ndihmë juridike, psikologjike, ekonomike, etj. Megjithatë Avokati i Popullit konstaton:

- Domosdoshmërinë për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve dhe koordinatorëve vendorë për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës. Në veçanti fokusi duhet vendosur te MKR-të e krijuara vitet e fundit, të cilat duhet të jenë të afta të vazhdojnë punën përtej mbështetjes së organizatave dhe donatorëve;
- Planifikimin dhe buxhetimin e nevojshëm në nivel vendor për shërbimet e viktimave të dhunës, në mënyrë të ndarë nga shërbimet sociale, për të identifikuar specifikisht fondet e nevojshme, rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve. Në përcakimin e prioriteteve, rëndësi duhet të marrin masat parandaluese dhe shërbime të specializuara që sjellin më shumë përfitime për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe në nivel afatgjatë ulin kostot financiare për shërbime të tjera si ndihma ekonomike, shërbimet e ndihmës ligjore, etj. Prioritetet duhet të shoqërohen me identifikimin e masave konkrete për realizimin e tyre, duke pasur parasysh përfituesit direkt dhe evidentimin e tyre me shifra.
- Vazhdimin dhe rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë të specializuara dhe kanë shpesh kapacitetet e nevojshme për të ndihmuar viktimat e dhunës. Por, bashkitë duhet të bashkëfinancojnë këto organizata për të siguruar qëndrueshmëri, përtej donatorëve të huaj dhe mbikqyrur aktivitetin e tyre rregullisht.
- Krijimin e qendrave/strehëzave të emergjencës, kostoja e të cilave nuk është detyruesisht shumë e madhe dhe bashkëpunimi me OJQ-të që ofrojnë këtë shërbim.
- Rritjen e mbikqyrjes në lidhje me veprimtarinë e koordinatorëve vendor dhe Ekipeve Teknike Multidisiplinare nga Komitetet Drejtuese të Mekanizmave të Referimit, institucionet drejtuese të bashkive dhe atyre qendrore që kanë në varësi zyrat vendore të disa prej anëtarëve të ENT për të siguruar funksionimin e rregullt, në bazë të legjislacionit. Mbikqyrja dhe monitorimi periodik është

⁴¹ Ibid.

një element shumë i rëndësishëm për përmirësimin e punës së këtyre strukturave. Procesi i monitorimit të 14 bashkive, në lidhje me SKBGJ 2016-2020, që për disa prej të cilave filloi nga viti 2017 deri në vitin 2020, nxorri në pah, jo vetëm sfidat, por edhe shërbeu si një nxitës për këto bashki të përmirësonin punën e tyre në këtë drejtim.

- Marrjen e masave administrative dhe penale ndaj anëtarëve të MKRs që nuk përmbushin detyrat e tyre ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.2 Monitorimi i ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes⁴²; marrja e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve; marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës; informacion mbi bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Në përgjithësi, bashkitë informojnë se realizojnë monitorimin e zbatimit të UMM dhe UM dhe shumë prej tyre që hartojnë raporte periodike çdo 60 ditë në lidhje me këtë monitorim. Megjithatë, pak bashki kanë dhënë informacion specifik për numrin e rasteve të monitoruara. Kështu, Bashkia Tiranë informon se gjatë periudhës Maj-Tetor 2021 janë dërguar **104 raporte periodike monitorimi të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes komisariateve përkatëse të policisë Tiranë** dhe në rastet kur janë evidentuar thyerje të masave të urdhërit të mbrojtjes, përveç dërgimit të menjëhershëm të raportit të monitorimit, është vënë në dijeni komisarati përkatës i policisë për vëmendje të shtuar; Bashkia Shkodër, gjatë vitit 2020 dhe 2021 (deri në shtator) ka ndjekur 220 raste të dhunës në familje për të cilat janë hartuar dhe dërguar raportet e monitorimit në organet e policisë, Bashkia Delvinë 6 raste për të cilat është hartuar raporti i monitorimit.

Edhe përsa i përket zbatimit të masave për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve, bashkitë në përgjithësi informojnë se kanë një bashkëpunim të mirë me organet e policisë dhe përmbarimit në këtë drejtim dhe se ky detyrim në përgjithësi zbatohet kur urdhërohet nga gjykata, me përjashtim kur viktimat e dhunës vendosin me dëshirën e tyre të largohen nga banesa e përbashkët kur ajo ndahet edhe me familjarë të tjerë të dhunuesit. Por informacioni për sa raste nga gjykata është dhënë një masë e tillë, nuk është i njohur dhe i qartë për të gjithë vendin. I vetmi informacion është marrë nga Zyra e Përmbarimit Tiranë drejtuar Bashkisë së Tiranës, ku gjatë periudhës Janar-Shtator 2021 janë regjistruar në total 22 Urdhëra Mbrojtje, nga të cilat vetëm tre kanë si objekt 'ndarjen e dhunuesit nga familja me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimave dhe

⁴² Në bazë të nenit 23, paragrafi 3/1 i ligjit 9669/2016 i ndryshuar, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm

fëmijëve”. Nga këto tre dosje përmbare, 2 janë ekzekutuar tërësisht dhe njëra është ende në proces ekzekutimi për shkak të problematikave të lindura gjatë fazës ekzekutive.

Përsa i përket organeve të policisë, bashkitë shprehen në përgjithësi për bashkëpunim të mirë me to dhe konfirmojnë se policia mbetet institucioni kryesor kur raportohet dhuna dhe burimi kryesor i informacionit në MKR për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare. Por, ka edhe bashki, si ajo e Himarës, që ka ngritur shqetësimin se rajoni i policisë nuk i njofton rregullisht për kallëzimet në polici dhe se infomohen vetëm pasi është marrë urdhëri i mbrojtjes nga Gjykata, me njoftim të kësaj të fundit.

Bashkëpunim i mirë rezulton edhe me zyrën e përmbaremit, ndërsa pak informacion është dërguar nga bashkitë në lidhje me bashkëpunimin me shërbimin e provës. Bashkia Tiranë informon se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, që prej muajit Gusht 2017, nuk ka zbatuar asnjë urdhër ekzekutimi për Mbikëqyrje Elektronike, pasi pajisja e gjurmimit e cila përdoret nga ky institucion për monitorimin e subjekteve, rezultoi pas një kohe të shkurtër se kishte probleme serioze teknike të cilat nuk garantonin sigurinë publike për zbatimin e masave të sigurisë “Arresti në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike.

Për këto arsye, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, ka informuar Prokurorinë dhe Ministrinë e Drejtësisë mbi keqfunksionimin e pajisjeve të gjurmimit elektronik si dhe marrjen e masave urgjente për vëzhgimin e subjekteve në monitorim. Si rrjedhojë e mosdisponimit të një sistemi të monitorimit elektronik efektiv, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës e ka pasur të pamundur vënien në ekzekutim të urdhërave të cilat parashikojnë, masat e sigurisë personale, me mbikëqyrje elektronike, përfshirë këtu dhe urdhërat e mbrojtjes për periudhën 1 Janar 2020 - 30 Shtator 2021.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përfshirjen gjithnjë e më të madhe të organeve të pushtetit vendor në zbatimin dhe monitorimin e masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje, ç’ka dëshkohet në përgjigjeve të tyre. Megjithatë Avokati i Popullit konstaton:

- Më shumë se gjysma e bashkive të vendit nuk kanë dërguar informacion mbi rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare të trajtuara nga MKR dhe ato për të cilat janë dhënë UMM/UM. Këtë informacion e kanë dërguar vetëm bashkitë Berat, Devoll, Dimal, Dropull, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Këlcyrë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Mallakastër, Poliçan, Pustec, Sarandë, Shkodër, Tepelenë, Tiranë dhe Vlorë. Disa nga këto bashki (me numër të vogël popullësie) informojnë edhe që nuk kanë pasur asnjë rast ose deri në 4 raste përgjatë 2020 dhe 2021 (deri në shtator). Ndarja e informacionit për numrin e rasteve të trajtuara është një element i rëndësishëm në lidhje me transparencën e bashkive dhe analizën e efektivitetit të MKR dhe punës së koordinatorëve të dhunës, të cilët duhet të luajnë një rol proaktiv në identifikimin e rasteve, në veçanti kur prevalenca e dhunës me bazë gjinore në bazë të INSTAT, por edhe raportimeve në polici, është shumë e lartë.
- Nevojën e koordinimit të ndërsjellë me organet e policisë dhe ato gjyqësore, sepse diferenca në nivel kombëtar ndërmjet numrit të raportimeve në polici, numrit të raseve të menaxhuara nga MKR-t sipas sistemit REVALB dhe vendimeve gjyqësore për UM/UMM (të trajtuara në seksionin 2 të këtij raporti) konfirmohet edhe nga të dhënat individuale të bashkive.)
- Në veçanti, ka rëndësi sqarimi ndërmjet organeve të policisë dhe bashkive në lidhje me raportet e monitorimit për UM që bashkitë duhet t’i dërgojnë policisë, pasi vihet re një kontradiktë midis

informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë, që për asnjë rast nga koordinatorët vendorë nuk është vënë në dispozicion raport monitorimi. (e trajtuar si çështje edhe në seksionin 2 të raportit).

4.3 Informacion mbi ngritjen e qendrave sociale e të riintegrit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje.

Bashkitë kanë dhënë informacion të përgjithshëm mbi ofrimin e shërbimeve më afatgjatë rintegruese për viktimat si bonuse qeraje, ose strehim në apartamente sociale, pagesë e çerdheve dhe kopshteve për fëmijët e mitur, referim e ndërmjetësim në zyrat e punësimit, etj. Disa bashki kanë dhënë informacion më të detajuar si Bashkia e Durrësit, Shkodrës, Tiranës, Vlorës, Elbasanit, Pogradecit edhe me shifra konkrete për përfitueset e disa prej këtyre shërbimeve (megjithatë në përgjithësi numrat janë të ulët në krahasim me nivelin më të lartë të rasteve të menaxhuara nga MKR-të ose atyre që kanë përfituar UM/UMM)⁴³.

Përsa i përket qendrave të mirëfillta sociale të rintegrit, pak bashki informojnë për ekzistencën e tyre dhe qendrat janë ngritur dhe financohen kryesisht me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe donatorëve.

Vlejnë të përmenden:

Bashkia Tiranë e cila informon se në strukturën e MKR-së përfshihet Strehëza për Gra dhe Vajza (OJF), e cila ka ofruar strehim afatgjatë për viktimat e dhunës në familje. Ndërkohë përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, MKR ka ofruar strehim emergjent për viktimat e dhunës në familje me organizatat jofitimprurëse si: “Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS” dhe “Plan & Go”; strehim afatgjatë me Qendrën Kombëtare të Trajtitimit të Viktimave të Dhunës në Familje, “Të Ndryshëm, të Barabartë” (OJF) dhe Strehëzën për Gra dhe Vajza (OJF).

Bashkia e Tiranës ofron shërbime sociale për viktimat e dhunës në familje në 5 qendrat komunitare lokale, administruar plotësisht nga Bashkia Tiranë sipas Ligjit 121/6 “ Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shërbime që përfshijnë identifikimin, informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, referimin drejt shërbimeve dhe ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore”.

⁴³ Psh Bashkia Tiranë njofton se ka mbështetur 107 përfituese nga kategoritë: kryefamiljare me fëmijë, vajza-nëna/ gra të dhunuara, me urdhër mbrojtje apo të divorcuara përmes programit social “Subvencionimi i Qirasë” për periudhën Janar 2020-Shtator 2021; të përfshijë gratë dhe vajzat, veçanërisht nga grupet e veçanta përmes programeve të nxitjes së punësimit në programin “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”, ku për vitin 2020 janë 52 përfitues të programit në total, ku nga këta 30 start-up dhe 22 ekzistues. Në vitin 2021 është çelur thirja për aplikim për të gjitha gratë dhe vajzat banore të Bashkisë Tiranë, kryesisht të kategorive në nevojë si gra kryefamiljare, gra nga zonat rurale, gra me aftësi të kufizuara, gra nga grupet e minoriteteve etnike, gra viktimat e dhunës në familje e të trafikimit etj

Bashkia Shkodër ka ngritur 12 qendra komunitare “Për familjen” (7 në zonat urbane dhe 5 në ato rurale) në të cilat ofrohet këshillim dhe programe për fëmijët dhe familjen si fuqizim ekonomik, programe prindërim, riintegrimi të fëmijëve në shkollë etj. Ndër të tjera, këto qendra mbështesin edhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime specifike sipas secilit rast.

Ndërkohë, Avokati i Popullit ka informacion që në disa bashki kryesore (Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër dhe Pogradec) me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe OKB-së janë duke u hartuar dhe zbatuar plane të riintegrit të viktimave të dhunës në familje.

Konstatime: Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e bashkive për ofrimin e shërbimeve më afatgjata që mundësojnë riintegrimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe krijimin e mundësive që të jenë të pavaruara ekonomikisht nga dhunuesit. Megjithatë Avokati i Popullit konstaton:

- Nevojën për krijimin e qendrave sociale që ndihmojnë për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje në shoqëri, në veçanti të atyre që për shkak të dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike kanë qënë të izoluar, pa mundësi për tu angazhuar në jetën sociale dhe punësim. Këto qendra mund të krijohen specifikisht për këtë qëllim, ose të integruara me shërbime që ofrohen për grupe të tjera në nevojë.
- Bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për shtrirjen dhe funksionimin e tyre në të gjithë rajonet e vendit dhe bashkëfinancimin e tyre.
- Mbikqyrjen e qendrave dhe paraqitjen e të dhënave specifike për përfituesit, për të identifikuar nevojat dhe efektivitetin e tyre.
- Shtrirjen e shërbimeve afatgjata dhe afatmesme për viktimat e dhunës me bazë gjinore në të gjitha bashkitë, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mundësi punësimi, për të siguruar pavarësinë ekonomike të grave viktimave të dhunës.
- Financimin e këtyre shërbimeve me plane konkrete edhe nga Pushteti Qendror.

4.4 Informacion mbi ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve dhe ofrimin e shërbimeve më afatgjata.

Për këtë çështje është raportuar edhe në Seksionin 3 dhe nga përgjigjet e bashkive konfirmohet që qendra këshillimi për djemtë dhe burrat ekzistojnë vetëm në Tiranë dhe Shkodër dhe të njëjta konstatime të seksionit 3 të raportit të Avokatit të Popullit vlejnë edhe për këtë nënseksion.

4.5 Informacion në lidhje me njohjen nga koordinatorët vendorë, anëtarët e MKR-ve dhe në përgjithësi bashkive të detyrimeve që rrjedhin nga VKM 327/2021 të 2 Qershorit 2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

VKM 327/2021 parashikon një sërë masash të rëndësishme për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, parandalimin dhe ofrimin e shërbimeve në nivel qendror dhe vendor. Ndërsa një pjesë e dispozitave të tij bazohen në VKM-të e mëparshme Nr.334, datë 17.02.2011, vendimi i ri parashikon një sërë masash të reja dhe përgjegjësish për institucionet, në përputhje me legjislacionin e përmirësuar të dhunës në familje dhe standardet ndërkombëtare.

Të gjitha bashkitë u përgjigjën se janë njohur me përmbajtjen e VKM 327/2021 dhe po ashtu edhe anëtarët e MKR-së. Njëkohësisht, në disa bashki janë zhvilluar aktivitete informuese ose trajnime të organizuara nga OKB, me qëllim njohjen e detyrimeve përkatëse.

Konstatime: Avokati i Popullit sjell ne vëmendje, aspektet e mëposhtme të këtij vendimi që duhet të fillojnë të zbatohen sa më shpejt në të gjitha bashkitë e vendit:

- Shtirirja e veprimit të VKM 327/2021, duke ngarkuar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVV) të trajtojnë jo vetëm rastet e dhunës në familje, por edhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore. *Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm që kërkon angazhim më intensiv dhe burime financiare të mjaftueshme nga bashkitë.*
- Detyrimi që në bashkitë e mëdha me mbi 200 000 (dyqind mijë) banorë të krijohet një njësi kundër dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) koordinatorë vendorë me kohë të plotë që bashkëpunojnë me nga një administrator shoqëror/punonjës social për çdo njësi administrative; *Nga të gjitha bashkitë e mëdha që iu përgjigjën Avokatit të Popullit, vetëm Bashkia Durrës informoi se ka angazhuar 2 koordinatorë me kohë të plotë, një për qytetin e Durrësit dhe një për zonën e Sukthit. Ndërsa bashkitë e tjera të mëdha cilësuan si shumë të nevojshme emërimin e të paktën 2 koordinatorëve me kohë të plotë. Ndërkohë, vlen të përmenden masat e disa bashkive (Tiranë, Durrës, Elbasan etj) që tashmë kanë angazhuar edhe administratorët shoqërorë të njërive administrative për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës).*
- Krijimi i Komitetit Drejtues dhe mbledhja e tij së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme.
- Roli i Komitetit Drejtues në veçanti në lidhje me efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës së shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor në varësi të funksioneve e të përgjegjësi që ka secili anëtar i komitetit drejtues.
- Krijimi i Ekipit teknik ndërdisiplinor (ENT) dhe mbledhja në mbledhje të zakonshme çdo muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave.
- Detyrimi i Policisë dhe autoriteteve të tjera për të njoftuar rregullisht koordinatorin vendor për çdo rast të raportuar dhune.
- Realizimi për çdo rast të dhunës në familje të vlerësimit dhe menaxhimit të riskut nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse, të cilët duhet ta kryejnë këtë proces sipas udhëzimeve të përbashkëta të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, për procedurat e vlerësimit të riskut dhe lëshimin e Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPM).
- Bashkëpunimi i rregullt ndërmjet Policisë dhe KVDHF për koordinimin e masave mbrojtëse afatshkurtra dhe afatgjata dhe përfshirja e koordinatorit për monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës.

Avokati i Popullit vëren se dy vitet e fundit janë marrë masa shumë të rëndësishme në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të legjislacionit dhe bazës nënligjore. Po ashtu, përmirësim ka në drejtim të mbrojtjes së viktimave dhe krijimit të strukturave të nevojshme në nivel lokal për adresimin e këtij problemi. Ndërkohë, pavarësisht zhvillimeve pozitive, më pak progress ka pasur në drejtim të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës dhe rehabilitimit të dhunuesve, ku rolin kryesor vazhdon ta luajë shoqëria civile me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve.

Më poshtë paraqiten rekomandimet kryesore të Avokatit të Popullit, të cilat rrjedhin nga konstatimet për çështjet e trajtuara në secilin seksion.

2. Legjislacioni:

- Hartimi i një kuadri ligjor që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore – krahas dhunës në familje - si ngacmimi dhe dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyrueshme, etj.
- Ndryshime ligjore ose nënligjore për të siguruar mënyra alternative për zbatimin e detyrimeve ligjore, që për momentin janë të pamundura për shkak të mungesës së disa shërbimeve, si për shembull detyrimi që ka gjykata të urdhërojë dhunuesit të ndjekin programe rehabilitimi, të cilat në praktikë nuk ekzistojnë në pjesën më të madhe të vendit.
- Ndryshimi i përkufizimit të veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë në Kodin Penal (si për madhorët ashtu edhe të miturit), në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Ndryshime në Kodin Penal në drejtim të përkufizimit të masave ndëshkuese në lidhje me martesat e detyrueshme, si dhe përfshirjen si vepra penale të sterilizimit të detyrueshëm dhe gjymtimit gjeneral, të dy këto, krime me natyrë seksuale të parashikuara si të tilla nga Konventa e Stambollit.
- Marrjen e masave për zbatimin me efektivitet të legjislacionit të përmirësuar.
- Ndryshimi i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të mundësuar aksesin paralel të viktimave të dhunës dhe përfitueseve të ndihmës ekonomike.
- Ndryshim të legjislacionit për të evidentuar zbatimin efektiv të programeve rehabilituese për dhunuesit.
- Ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit ekzistues për tu dhënë mundësinë viktimave të dhunës në familje për tu paraqitur drejtpërdrejtë pranë institucionit të Mjekësisë Ligjore për tu egzaminuar pa qenë nevoja e pajisjes më parë të tyre me vendim nga organi procedues ose Avokati i Popullit.

4. Mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna

- Kooordinim më të mirë të MKR-ve me strukturat e policisë për të referuar në mënyrë të ndërsjellët rastet e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës.

- Zgjerimin e fushatave ndërgjegjësuere për raportimin e dhunës në të gjithë vendin, si një mënyrë efikase për ti bërë viktimat të thyejnë ciklin e dhunës dhe të marrin ndihmën e nevojshme; shoqërimin e fushatave ndërgjegjësuere me programe për rritjen e kapaciteteve të strukturave ku raportohet dhuna.
- Marrjen e masave për shtrirjen e Linjës së Këshillimit, ose krijimin e strukturave të ngjashme në të gjithë vendin, në veçanti në zonat e thella rurale, si edhe për gratë nga grupet e pafavarizuara, si gratë me aftësi të kufizuara, ato nga komuniteti Rom, gratë e moshuara, LBT.
- Ndërgjegjësimin e gjithë autoriteteve përgjegjëse që kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të përcaktuar në ligj.
- Vënien përpara përgjegjësisë të personave të cilët marrin dënim për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës dhe nuk veprojnë në zbatim të tij.
- Aktivitetet ndërgjegjësuere kundër dhunës me bazë gjinore duhet të organizohen vazhdimisht dhe të mos kufizohen vetëm gjatë fushatave specifike, si psh fushata ndërkombëtare e 16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.
- Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e procedurave të miratuara të vlerësimit të riskut, në të gjithë vendin dhe përshtetimin e programeve trajnuese për punonjësit e policisë nga vetë institucionet shqiptare, krahas mbështetjes që ofrohet nga organizatat ndërkombëtare.
- Kontrollin e zbatimit të procedurave të vlerësimit të riskut dhe lëshimit të UMMPM, nga strukturat mbikqyrëse përkatëse dhe evidentimin periodik të problemeve që shfaqen në praktikë.
- Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për të ndarë të dhënat dhe zbatueshmërinë e urdhrave për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPM).
- Zbatimi me prioritet i largimit të dhunuesit nga banesa e përbashkët si masën e parë dhe kryesore që duhet të merret nga Gjykatat kur dhunuesi dhe i dhunuari/e dhunuara, banojnë në një strehë të përbashkët dhe gjithashtu si masa e parë në urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme që lëshohen nga policia, derisa gjykata të lëshojë urdhërin e përkohshëm të mbrojtjes.
- Shtimi i burimeve njerëzore në zyrat e përmbarimit dhe trajnim të vazhdueshëm të stafit për zbatimin me rigorozitet të UMM dhe UM dhe për të siguruar mbrojtje efiksase.
- Rritje e bashkëpunimit të vazhdueshëm të zyrave lokale të përmbarimit gjyqësor, organeve të policisë dhe njësive vendore/koordinatorët e dhunës në familje, për të siguruar zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.
- Monitorim më specifik nga organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë të shkaqeve për diferencën e madhe ndërmjet raportimeve në polici dhe kërkesë-padive për marrjen e masave të mbrojtjes, me numrin e vendimeve për UM/UMB aktuale që lëshohen nga gjykatat.
- Përfshirja dhe bashkëpunimi i organeve të pushtetit vendor (shërbimet sociale, koordinatoret kundër dhunës në familje etj) për monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me detyrimin ligjor që kanë, si dhe mbajtjen e përgjegjësisë për mospërbushjen e këtij detyrimi.
- Ndjekjen e mëtejshme dhe sqarimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, komisariateve lokale dhe bashkive, për mospërputhjen e informacionit të dërguar nga Drejtoria e Policisë dhe bashkive për raportet e monitorimit të UM/UMM.

- Trajtimi në mënyrë më specifike si femicid i vrasjes së grave në marrëdhëniet familjare ose vrasja e grave në përgjithësi, në të gjithë kompleksitetin e këtij fenomeni, si dhe zbatimin me rigorozitet të procedurave të vlerësimit të riskut, në momentin e parë që raportohet apo konstatohet dhunë në marrëdhëniet familjare, për të ofruar menjëherë masa mbrojtëse të përshtatshme që shmangin vrasjet dhe format e tjera të dhunës në familje, në veçanti largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga streha e përbashkët.
- Vënien para përgjegjësisë penale dhe administrative të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar vrasje në marrëdhëniet familjare ose dëmtime të rënda.
 - Rritje e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve mbikqyrëse të sistemit të drejtësisë për të trajnuar dhe monitoruar vendimet e gjykatës për masat mbrojtëse,
 - Përsheptim të procedurave të zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike të ofruar nga shteti për të mbushur boshllëkun disa vjeçar që krijoi zbatimi i ligjit për ndihmën juridike falas.
 - Rritjen e numrit të viktimave të dhunës në familje që përfitojnë ndihmë juridike nëpërmjet fondeve publike (Drejtoria e Ndihmës Juridike).
 - Monitorimi i lëshimit të raporteve mjeko-ligjore, i cili është shumë më i vogël se numri aktual i procedimeve gjyqësore për masa mbrojtje dhe veprës penale të dhunës në familje dhe trajnime të vazhdueshme për stafin mjeko-ligjor dhe gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, me iniciativën e vetë institucioneve të drejtësisë për to në shkallë vendi.
 - Angazhim i organeve qeverisëse dhe monitoruese të sistemit të drejtësisë për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së vendimeve që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse dhe procedimet penale për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore.
 - Publikimin nga Ministria e Drejtësisë brenda një kohe sa më të shpejtë të të dhënave statistikore për çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për vitin 2020 dhe 2021.

5. Planifikimi dhe koordinimi i shërbimeve për të mbijetuarat në nivel qendror

- Rritjen e financimit të projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social, në veçanti për bashkitë ku kjo nevojë është e domosdoshme për shkak të numrit të lartë të rasteve.
- Monitorimi i projekteve për ngritjen e qendrave ekzistuese dhe përdorimi efikas i fondeve përkatëse.
- Qartësimi dhe plotësimi i të dhënave mbi shpenzimet e MSHMS për shërbime të ndryshme ndaj viktimave të dhunës në familje për të cilat janë lëshuar UM ose UMM.
- Shtimi i fondeve si dhe përcaktimi i procedurave ligjore të qarta, transparente dhe kompetitive për nën-kontraktimin e organizatave jo qeveritare nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, për ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në familje (dhe potencialisht ndaj viktimave të formave të tjera të dhunës).
- Përsheptimi i masave mbështetëse nga MSHMS për MKR-të për të siguruar një funksionim sa më efektiv të të gjithë mekanizmave, në veçanti atyre të krijuara rishtazi, për të mundësuar që krijimi i tyre të mos jetë thjesht një formalitet, por një mekanizëm real që trajton rastet e dhunës

në marrëdhëniet familjare në të gjithë zonat e vendit, përfshi ato rurale.

- Angazhimi dhe dedikimi i fondeve publike për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve për të siguruar një qëndrueshmëri të funksioneve të tyre, përtej mbështetjes që aktualisht ofrohet nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.
- MSHMS duhet të paraqesë informacion mbi masat e ndërmarra për mbështetje financiare dhe teknike për të gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e "përshtatjes së arsyeshme", që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje.
- Nevojën për trajnime dhe mbikëqyrje të sektorit të shëndetësisë, i cili mbetet një nga sektorët ku janë shfaqur më tepër problematika në drejtim të rolit të tyre për referim të rasteve të dhunës si dhe hartimit të raporteve mjekësore mbi çdo dëmtim, të nevojshme për tu përdorur në proceset gjyqësore nga viktimat.
- Intesifikimin e masave mbështetëse dhe monitoruese nga MSHMS për mbledhjen dhe koordinimin e sistemit të të dhënave dhe shtrirjen e sistemit REVALB në të 61 bashkitë e vendit, pasi ky shërbim aktualisht realizohet vetëm në pak më shumë se gjysmën e Bashkive në vend; hedhjen rregullisht të të dhënave nga të gjithë institucionet që kanë detyrimin ligjor, në veçanti të strukturave lokale si dhe publikimin e të dhënave në mënyrë periodike.
- Përsheptimin e përpjekjeve për ngritjen e qendrave/programeve rehabilituese për dhunuesit në të gjitha qarqet e vendit, sa më shpejt dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ pasi programet aktuale janë të pamjaftueshme.
- Nevojën për një bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse, përfshi policinë, gjykatën, shërbimet e provës dhe drejtorisë së burgjeve, për identifikimin dhe përfshirjen në programet e rehabilitimit të shkaktarëve të dhunës në familje.
- Nevojën për shtrirjen e këtyre shërbimeve edhe për shkaktarët e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhunës seksuale, ngacmimit, përndjekjes, etj.

Rekomandime në lidhje me Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të dhunës në Familje dhe Qendrës së Trajtimit të Viktimave të Dhunës Seksuale

- Zbatimin e menjëhershëm të standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje, për të siguruar të gjitha shërbimet e nevojshme, përfshi nevojat bazë të grave dhe fëmijëve që strehohen si: veshëmbathje dhe ngrohje, masat e përkujdesjes për rehabilitimin e tyre nga trauma, si dhe rritjen e kapacitetit të stafit të qendrës për njohjen e këtyre standarteve.
- Ngritja e qendrave afatgjata për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në qarqet kryesore të vendit për të qenë të aksesueshme për të gjitha gratë, përfshi ato nga zonat rurale, si dhe të aksesueshme për gratë me aftësi të kufizuara.
- Zbatimin e menjëhershëm të standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës Seksuale (LILIUM), në veçanti standardin bazë për ekzaminimin e rasteve në ambientet e qendrës - pasi është cënuar parimi bazë i saj për "siguri dhe dinjitet njerëzor", mbështetjen psikologjike për viktimat, plotësimin me paisje që lehtësojnë ekzaminimet, referimin drejtpërdrejtë nga Policia në qendër të rasteve të dhunës seksuale dhe koordinimin me

shërbimet e tjera mjekësore që duhet të ofrohen.

- Nevojën për ngritjen e qendrave të tjera rajonale, të specializuara për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës seksuale, pasi një qendër për të gjithë vendin, është e pamjaftueshme dhe mund të jetë e vështirë për tu aksesuar nga viktimat e dhunës seksuale që jetojnë larg vendodhjes së saj.
- Mbështetje të mëtejshme nga qeveria të organizatave jo qeveritare dhe strehëzave që mund të ofrojnë shërbime më afatgjata dhe të specializuara për viktimat, pasi zakonisht, edhe në vendet e tjera këto qendra janë më të specializuara dhe kanë më tepër kapacitete për tu ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme viktimave të dhunës seksuale.

Rekomandim për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të zbatojë detyrimet e saj të përcaktuara qartë në legjislacionin kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.

4. Menaxhimi i rasteve nga Mekanizmat e Referimit dhe ofrimi i shërbimeve në nivel lokal.

- Marrja e masave nga pushteti lokal për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve dhe koordinatorëve lokalë për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës.
- Planifikimin dhe buxhetimin e nevojshëm në nivel lokal për shërbimet e viktimave të dhunës, në mënyrë të ndarë nga shërbimet sociale, për të identifikuar specifikisht fondet e nevojshme si dhe rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve. Prioritetet buxhetore duhet të shoqërohen me identifikimin e masave konkrete për realizimin e tyre, duke pasur parasysh përfituesit direkt dhe evidentimin e tyre me shifra. Ka nevojë për ndryshimin e politikave të buxhetimit, për të bërë të mundur që fondet të jenë të përcaktuara në nivel qendror dhe lokal, pasi bashkitë e vogla nuk kanë fare fonde për të tilla shërbime.
- Vazhdimin dhe rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë të specializuara dhe kanë shpesh kapacitetet e nevojshme për të ndihmuar viktimat e dhunës, duke siguruar edhe bashkëfinancim të pushtetit vendor për këto organizata, për të siguruar qëndrueshmëri, përtej donatorëve të huaj dhe mbikqyrur aktivitetin e tyre rregullisht.
- Krijimin e qendrave/strehëzave të emergjencës, kostoja e të cilave nuk është detyrimisht shumë e madhe dhe bashkëpunimi me OJQ-të që ofrojnë këtë shërbim.
- Rritjen e mbikqyrjes në lidhje me veprimtarinë e koordinatorëve dhe Ekipeve Teknike Multidisiplinare nga Komitetet Drejtuese të Mekanizmave të Referimit, institucionet drejtuese të bashkive dhe atyre qëndrore që kanë në varësi zyrat vendore të disa prej anëtarëve të ENT, për të siguruar funksionimin e rregullt, në bazë të legjislacionit.
- Marrjen e masave administrative dhe penale ndaj anëtarëve të MKR-s që nuk përmbushin detyrat e tyre ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mbajtja dhe përditësimi i rregullt I të dhënave për numrin e rasteve të trajtuara nga MKR-të, I cili është një element i rëndësishëm në lidhje me transparencën e bashkive dhe analizën e efektivitetit të MKR-ve dhe punës së koordinatorëve të dhunës.

- Nevojën e koordinimit të ndërsjelltë të pushtetit vendor me organet e policisë dhe ato gjyqësore.
- Sqarimi ndërmjet organeve të policisë dhe bashkive në lidhje me raportet e monitorimit për UM që bashkitë duhet t'i dërgojnë policisë, pasi vihet re një kontradiktë midis informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë, që për asnjë rast nga koordinatorët vendor, nuk është vënë në dispozicion raport monitorimi dhe informacionit të dërguar nga bashkitë, shumica dërmuese të të cilave informojnë se e kryejnë këtë monitorim dhe përgatisin raporte, të cilat i ndajnë me policinë.
- Nevojën për krijimin e qendrave sociale që ndihmojnë për riintegrimin e viktimave të dhunës në familje në shoqëri, në veçanti të atyre që për shkak të dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike kanë qenë të izoluar, pa mundësi për tu angazhuar në jetën sociale dhe punësim. Këto qendra mund të krijohen specifikisht për këtë qëllim, ose të integruara me shërbime që ofrohen për grupe të tjera në nevojë.
- Bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për shtrirjen dhe funksionimin e tyre në të gjithë rajonet e vendit dhe bashkëfinancimin e tyre.
- Mbikqyrjen e qendrave dhe paraqitjen e të dhënave specifike për përfituesit, për të identifikuar nevojat dhe efektivitetin e tyre.
- Shtrirjen e shërbimeve afatgjata dhe afatmesme për viktimat e dhunës me bazë gjinore në të gjitha bashkitë, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mundësi punësimi, për të siguruar pavarësinë ekonomike të grave viktimave të dhunës.
- Marrjen e masave për zbatimin sa më shpejtë të detyrimeve që rrjedhin nga VKM 327/2021 të 2 Qershorit 2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës" dhe në veçanti të risive të tij, duke përfshirë:
 - Detyrimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NVV) të trajtojnë jo vetëm rastet e dhunës në familje, por edhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore.
 - Detyrimin që në bashkitë e mëdha me mbi 200 000 (dyqind mijë) banorë të krijohet një njësi kundër dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) koordinatorë vendorë me kohë të plotë që bashkëpunojnë me nga një administrator shoqëror/punonjës social për çdo njësi administrative;
 - Krijimin e Komitetit Drejtues të MKR-s dhe mbledhja e tij së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme.
 - Rritja e rolit mbikqyrës mbi ENT të Komitetit Drejtues dhe shtrirja e veprimtarisë në lidhje me efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës së shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor, në varësi të funksioneve e të përgjegjësisë që ka secili anëtar i komitetit drejtues;
 - Organizimi i mbledhjeve të zakonshme të ENT-së çdo muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave.
 - Detyrimi i Policisë dhe autoriteteve të tjera për të njoftuar rregullisht koordinatorin vendor për çdo rast të raportuar dhune.

- Realizimi për çdo rast të dhunës në familje të vlerësimit dhe menaxhimi i riskut nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse.
- Bashkëpunimi i rregullt ndërmjet Policisë dhe KVDHF për koordinimin e masave mbrojtëse afatshkurtra dhe afatgjata dhe përfshirja e koordinatorit për monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës.